

XHEVAT LLOSHI

VËZHGIME MBI HOMONIMET NË GJUHËN SHQIPE

Studimi i gjithanshëm dhe i thelluar i materialit faktik gjithnjë e më të madh, që po grumbullohet për gjuhën shqipe, shtron nevojën e trajtimit edhe të çështjeve të veçanta gjuhësore, si është çështja e homonimisë në gjuhën shqipe.

Shqyrtimi i anëve të ndryshme të homonimisë në leksikologji sjell me vehte edhe një mënyrë të caktuar të paraqitjes së homonimeve në veprat leksikografike. Leksikografia shqipe e paraqirimit përfshin një sërë fjalorësh, tek të cilët kemi një zgjidhje praktike të çështjes sipas autorit, por pa një përgjithësim të saj në parathëniet e fjalorëve ose në diskutimet e zhvilluara më pas rreth tyre. Në parathënien e fjalorit të A. Leotti-it ¹⁾, kur flitet për theksin, shihet në të vërtetë problemi i homografeve, si del nga shembujt e dhënë: *gati-gati, edhe-edhé, dolli-dolli, pusi-pusi, fole-folé* etj. , ndonëse homografet zënë një vend më të vogël se sa homonimet e paraqitura në po atë fjalor. Duke shqyrtuar fjalët e përsëritura në fjalorin e F. Cordignano-s prof. A. Xhuvani ²⁾ arrinte në përfundimin: "Për të gjitha këto fjalë e për të tjera si këto ishte dashtë me u-regjistruar një herë vetëm, tue u ndjekë mënyra që u kallzue më nalt, sikurse veprohet në gjithë Fjalorët e botës". Jo drejtpërdrejt këtu kemi të bëjmë me homonimet në fjalor: fjalët që nuk janë homonime duhen pasqyruar në fjalor vetëm një herë.

Po të lihen mënjatë përmendjet e veçanta të homonimisë në studime që s'kanë të bëjnë me leksikologjinë e leksikografinë, na del kështu që paraqirimit nuk ndeshemi me trajtimin e çështjeve të homonimisë në gjuhën shqipe.

Pas çlirimit, me sa duket për herë të parë në hyrjen e një fjalori të shqipes, përmenden homonimet tek Fjalori i shkurtër shqip-rusisht ³⁾, ku thuhet: "Omonimet jepen veçan me germa të zeza dhe ndahen me shifra romake". Në shenimet mbi përdorimin tek Fjalori i Gjuhës shqipe ⁴⁾ kemi edhe një përpjekje për të dhënë përkufizimin e homonimeve në gjuhën shqipe: "Fjalët që ngjajnë në shqiptim, por ndryshojnë shumë nga kuptimi (homonimet) janë vënë si fjalë të veçanta". Një formulim më të përpiktë kemi po në këtë fjalor, kur shpjegohet fjala *homonim*: "thuhet për një fjalë që ka të njejtën trajtë fonetike me një tjetër, po kuptimet janë të ndryshme".

Përveç fjalorëve, anë të veçanta të homonimisë kanë tërhequr vëmendjen edhe në punime të tjera për gjuhën shqipe, si për homoniminë e for-

1) A. Leotti, *Dizionario albanese-italiano*, Roma 1937, f. XIX.

2) A. Xhuvani, *Studime gjuhësore*, T. 1956, f. 163.

3) *Fjalori i shkurtër shqip rusisht*, nën red. e A. Kostallarit, M. 1951 f. 14.

4) *Fjalori i gjuhës shqipe*, T. 1954, f. V.

5) *Po aty*, f. 173.

mave në gramatikë⁶), ndikimi i homonimisë në historinë e fjalëve të veçanta⁷), ose në tekstet dhe dispencat si material mësimor). Një vlerësim të drejtë të nevojës për të marrë parasysh homoniminë në trajtimin e prapashtesave, e rrjedhimisht të gjithë morfemave, kemi në artikullin e prof. M. Domit "Vepër themelore me rëndësi teorike e praktike"⁸), ku theksohet: "Një zgjidhje jo të njëjtë e, na duket, ndonjëherë jo me vend, ka gjetur çështja e prapashtesave homonimike. Ka raste kur prapashtesat e tilla janë dalluar dhe janë marrë me të drejtë si prapashtesa të ndryshme, e shqyrtuar secila veçan, si p.sh. -i e fjalëve si: bukuri, krushqi, dhe -i e fjalëve si ari, njeri, -çe e emrave si birçe dhe -çe e ndajfoljeve të mënyrës: shqiptarçe. Por në mjaft raste të tjera prapashtesat homonimike, që mund të kenë patur të njëjtin burim, por zhvillimi historik i ka larguar mjaft njera prej tjetrës dhe sot ndjehen si prapashtesa të ndryshme, janë trajtuar, na duket, pa të drejtë, si një prapashtesë e vetme. Kjo ndodh ndonjëherë edhe kur nga ana historike s'kemi të bëjmë me një të vetme prapashtesë, por me një homofoni të thjeshtë".

Me sa duket, për trajtimin teorik të çështjeve të homonimisë në gjuhën shqipe mungojnë studime të gjithanëshme dhe përgjithësuese, gjë që natyrisht ka lënë gjurmën e vet dhe në praktikën leksikografike. Prandaj me plot të drejtë në artikullin e A. Kostallarit "Në rrugën e hartimit të fjalorit normativ të shqipes"⁹) nënvizohet: "Të gjitha këto tregojnë se sa i nevojshëm dhe aktual është studimi i këtij problemi në gjuhën tonë, shtrojnë detyrën e rëndësishme të kërkimeve të hollësishme në lëmin e homonimisë, me qëllim që të përcaktohet drejt përmbajtja e nocionit "homonimi" në gjuhën tonë, të bëhet klasifikimi i homonimeve, të përcaktohen tendencat që vihen re në gjuhën shqipe në këtë fushë dhe të vendosen parimet e drejta për trajtimin e homonimeve në praktikën tonë leksikografike".

2.

Në kuptimin e gjerë të fjalës, homonimia përfshin të gjitha llojet e tingëltimeve të njëjta; kështu flasim për homonimi gramatikore, kur përputhen të tingëllim format e ndryshme të po asaj fjale, kemi homonimi të morfemave, të togjeve të tërë etj. Do të ndalemi këtu vetëm me homoniminë që ka të bëjë me fjalët, me njësitë e leksikut dhe në planin leksikor.

Homonimi do të quanim përputhjen tingëllore të njëjtimeve leksikore të ndryshme. Homonimet atëhere janë fjalë të ndryshme, por me të njëjtin tingëllim. Prandaj, që të kemi homonimi, para së gjithash duhet të kemi dy ose më shumë fjalë, dy ose më shumë njësi leksikore. Së dyti, këto fjalë

6) Shih. S. Riza "Pronorët e shqipes", "Bul. Un. Sht. të Tiranës, S. Shk. Shoq." 195 Nr 2, f. 61 dhe në shënimin 13; gjithashtu A.V. Desnickaja "Mbi strukturën morfologjike të gjuhës shqipe në "Вопросы языкознания", 1958. Nr. 3, f. 13.

7) Shih E. Çabej, *Studime rreth etimologjisë së gjuhës shqipe*, IV, "Bul. Un. Sht. të Tiranës, S. Shk. Shoq." 1961, Nr. 3, f. 62 për fjalën *dru*, edhe: *Studime rreth etimologjisë së gjuhës shqipe* VIII, "Bul. Un. Sht. të Tiranës, S. Shk. Shoq." 1962, Nr.3, f. 62 për fjalën *gëth*.

8) Shih J. Stefi, *Leksikologjia shqipe*, dispensë, 1961, f. 27-32; A Dodi, *Fonetika e gjuhës së sotme shqipe*, dispensë, 1963, f. 74, 77.

9) M. Domi, *Vepër themelore me rëndësi teorike e praktike*, në "Zëri i Popullit" dt. 9-II 1963, f. 3.

10) A. Kostallari, *Në rrugën e hartimit të fjalorit normativ të shqipes*, "Bul. për Shk. Shoq.", 1955, Nr. 4, f. 39.

duhet të tingëllojnë krejt njësoj, në rast të kundërt nuk kemi më homonimi, por paronimi, tingëllim të ngjashëm, po jo të njëjtë, si p.sh. folja *pres* dhe emri *presë* nuk janë homonime. Së treti, fjala është njësi leksikore, që i përket një pjese të caktuar të ligjeratës, ajo nuk ka vetëm kuptimin leksikor, por ka edhe atë gramatikor, kuptimi i saj themelor është i ndërlikuar me këto ose ato kuptime gramatikore, që shprehen materialisht në dallimet e jashtme tingëllore. Emri *hap* dhe folja *hap* dallohen edhe nga kuptimet leksikore, edhe nga që i përkasin pjesëve të ndryshme të ligjeratës, ndërsa emri *verë* për një pije dhe *verë* për stinë dallohen vetëm nga kuptimi leksikor. Kjo do të thotë që, për një pjesë të homonimeve, lypset të shihet edhe ana gramatikore, meqë vetë pjesa e ligjeratës është një kategori leksiko-gramatikore.

Vemendjen kryesore e meritojnë homonimet e mirëfillta, *homonimet leksikore*, që janë dy ose më shumë fjale, të cilat tingëllojnë njësoj, kanë kuptime leksikore krejt të ndryshme dhe i përkasin të njëjtës pjesë të ligjeratës. Si të tilla, homonimet leksikore ndahen vetvetiu në homonime ndërmjet emrave, ndërmjet foljeve, mbiemrave etj. Nga materiali i mbledhur del se në gjuhën shqipe homonimet leksikore ndeshen në shumicën dërmuese ndërmjet emrave, janë të kufizuara ndërmjet foljeve, të pakta ndërmjet mbiemrave dhe shumë të rralla ndërmjet pjesëve të pandryshueshme të ligjeratës; kështu nuk kemi ndeshur p.sh. ndajfolje homonime me njera tjetrën.

Klasifikimi i mëtejshëm i homonimeve leksikore nuk mund të bëhet, pa zgjidhur një varg çështjesh të veçanta. Në të gjitha rastet është e nevojshme t'i përgjigjemi pyetjes: a kemi një fjalë të vetme, apo dy e më shumë, që vetëm tingëllojnë njësoj? Po ta marrim në një drejtim të caktuar tingëllimin e fjalës si formë, kurse kuptimin e saj si përmbajtje, atëherë pyetja do dilte e tillë: a kemi një formë të vetme me përmbajtje që ndryshon sipas rastit, apo kemi disa forma të njëjta me disa përmbajtje të ndryshme? Nga ana tjetër, ka rëndësi të zbulohet arsyeja, që në gjuhë lind homonimia, dhe me këtë të shpjegohet si gjuha pajtohet në pjesën më të madhe të rasteve me këtë fenomen, që është në kundërshtim me funksionin e shenjave në gjuhë.

Përgjigjen e këtyre pyetjeve na duket se mund ta gjenim, po të ndiqnim rrugën e lindjes së homonimeve në gjuhën shqipe. Nga vëzhgimet e bëra del, se rrugët e lindjes së homonimeve mund të jenë këto: ndryshimi ose evolucioni fonetik; ndryshimi dhe shkëmbimi i fjalëve ndërmjet dialekteve dhe dialekteve me gjuhën e përbashkët; huazimet; fjalëformimi; zbrëthimi i polisemisë. Të ndalemi shkurt në secilën rrugë, duke shqyrtuar edhe anët e veçanta, që zbulon secila prej tyre.

Gjatë ndryshimit, evolucionit fonetik, kanë dalë si homonime fjalët *anë*₁ për krah, brinjë etj. dhe *anë*₂ për enë. Dikur këto fjalë përfaqësonin rrënjë krejt të largëta, për *anë*₁ do menduar një **anda*¹¹⁾, ndërsa për *anë*₂ një neutër i vjetër *ânëtë*. Me asimilimin e bashkëtingëlloreve dhe errësimin e zanores jo nën thekës, sot kemi po atë kompleks tingujsh *anë*. Po kështu janë përputhur në tingëllimin e tyre fjalë dikur krejt të largëta si p.sh. *bajzë* për hobe e lidhur me *bazë* < *bae* dhe *bajzë*₂ për një shpend uji, si duket nga *balzë* për shkak të njollës që ka¹²⁾; *arrç*₁ për arrëz e zverkut lidhet

11) Shih E Çabej, *Studime rreth etimologjisë së gjuhës shqipe*. I "Bul. Un. Sht. të Tiranës, S. Shk. Shoq.", 1960, Nr. 4, f. 18-19.

12) Po aty, f. 37.

me *arrëz*, ndërsa *arrëz*₂ për dosëz lidhet me foljen *harr*; ¹³⁾ *cule*₁ për fyell, *cule*₂ për barrë, deng dhe *cule*₃ për rrecka, shtresa mendohet ¹⁴⁾, se lidhen me burime etimologjike mjaft të largëta, e para me *cull*, *calik*, *cullik*, e dyta me serbokroat. *surla*, e treta me *cërule*, *crule*, *crulak*. Me këtë rrugë kanë dalë si homonime folje kaq të përdorura si *pres*₁-*pres*₂, *pjek*₁-*pjek*₂, emrat *verë*₁-*verë*₂, *urë*₁-*urë*₂ etj.

Meqë këtu nga ana etimologjike kemi fjalë që nuk kanë patur asgjë të përbashkët ndërmjet tyre, këto homonime quhen edhe homonime etimologjike ¹⁵⁾. Që këtej mund të nxirren dy përfundime: së pari, për të gjetur në se kemi të bëjmë me homonimi ose jo, mund të na ndihmojë në mjaft raste parimi etimologjik i dallimit të fjalëve, mjafton të vërtetojmë se etimologjikisht kemi të bëjmë me fjalë të ndryshme, për të shpjeguar pse kemi edhe kuptime krejt të largët dhe, rjedhimisht, homonimi. P.sh. për homonimet *bli*₁ një pemë dhe *bli*₂ një peshk, mjafton të tregohet burimi i tyre etimologjik i largët.

Së dyti, kemi konstatuar në këtë mënyrë një nga arësytet themelore, që në gjuhë lindin homonime: gjuha ndryshon, zhvillohet. Ndryshimi edhe zhvillimi i saj bëhen në drejtime të caktuara, në bazë të ligjeve dhe rregullave të brendshme të saj, gjë që mund të shpjegohet në përputhjen e pashmangëshme tingëllore të fjalëve të largëta.

Lëvizshmëria dhe ndryshimet në gjuhë ndjehen në mënyrë të veçantë në dialektet tona dhe në gjuhën e folur. Prandaj atje kemi shumë më tepër mundësi për lindjen e homonimeve, se sa në gjuhën e shkruar, të ngulitur njëherë e përgjithmonë. Mungesa e një atlasit dialektor për shqipen e heq mundësinë për një përshkrim të përpiktë të fenomeneve, që sjellin në homonimi sipas dialekteve dhe për përcaktimin e përhapjes së tyre.

Homonimet në dialektet mund të kufizohen brenda caqeve të dialektit të dhënë. Kështu në toskërisht kemi *verë*₁-*verë*₂, *urë*₁-*urë*₂, por në gegërisht ato nuk janë homonime. Fjalët *gjoll*-i (copë tokë e mbjellë) dhe *gjollë*-a në krahinën e Pogradecit dalin homonime *gjollë*₁ — (rrasë ku i venë bagëtisë kripën) -*gjollë*₂. Mirëpo sot, kur për arësytë të thella social-ekonomike, kemi një përzierje të folësve nga çdo krahinë, kur gjuha e përbashkët pasurohet me fjalë nga dialektet, kur po bëhet një mbledhje sistematike e thesarit leksikor, kemi patjetër ndeshjen e fjalëve homonime të dialekteve të ndryshme ndërmjet tyre dhe të fjalëve nga dialektet me ato që janë fjalë të mbarë gjuhës. Është e natyrshme që kjo gjendje do të pasqyrohet edhe në fjalorë. Shembuj të të dy rasteve mund të gjenden mjaft. Kompleksi i tingujve *fijoj* përfaqëson sot disa homonime të kësaj natyre. Në Skrapar *fijoj*₁ është për *vloj*, pra nga *fej*₁, *fijoj*₂ për filloj; në veri gjejmë *fijoj*₃ për gaboj lidhur me *fëlej*, *fëj*₁ në jugë, ndërsa *fijoj*₄ del për shtie në finjë, nga një *finj*₁, dhe kemi një *fijon* (homonime e pjesëshme) për bie dëborë fije-fije. Asimilimi, palatalizimi etj., bëjnë që nga *djalë* dhe *ngj lë* të kemi homonimet *gjalë*₁-*gjalë*₂; fjala *derk* për derrkuc del homonime me *derk* për zverk (ndoshta *dverk* > *derk*); *merë*₁ për masë (sllav.) me *merë*₂ për aromë dhe *merë*₃ nga *tmerr*; *çile*₁ shkëlqen penjësh, *çile*₂ dhi e murme, *çile*₃ arrë fyle; *brojë* për një enë dhe *brojë*₂ për bregcën; *bacë*₁ për dackë dhe *bacë*₂ për vellanë e madh, ungjin; *bilan*₁ për rrip të kalit dhe *bilan*₂ për buall të zi; *dashe*₁ jastëk gjilpërash dhe *dashe*₂ pufka misri; *dojkë*₁ për tajë

13) Po aty, f. 27.

14) E. Çabej, *Studime rreth etimologjisë së gjuhës shqipe*, II, "Bul. Un. Sht. të Tiranës, S. Shk. Shoq." 1961, Nr. 1, f. 68.

15) Shih Ch. Bally, *Traité de Stylistique française*, 2 tomes, Genève—Paris 1951, f. 44; edhe S. Ullmann, *Précis de sémantique française*, 2 Berne, 1959, f. 220.

(bullg.) dhe *dojkë*₂ për lodrën doçkë; *çikëz*₁ një lloj rrjete dhe *çikëz*₂ zvo-gëluese e *çikë*; *gocë*₁ për vajzë dhe *gocë*₂ nga goçkë, guaskë; nga foljet: *shaj*₁ për mëshaj dhe *shaj*₂ fshaj, *mbloj*₁ për fejoj, *mbloj*₂ për mbush etj.

Nga fjalët e dialekteve, që dalin homonime me fjalët e njohura gjerësisht, mund të përmendim: *çupë*₁ dhe *çupë*₂ maja e *kokës* (ndoshta sllav.); *çukë* dhe *çukë*₂ quakë, dele me veshë të qukur; *dem*₁ dhe *dem*₂ përmirësim i kohës (ndoshta lidhet me dehet koha); *çurkë*₁ dhe *çurkë*₂ misëroke; *damë*₁ dhe *damë*₂ për model; *hije*₁ dhe *hije*₂ nga *ije* me një *h-* të shtuar në fillim; *shtroj*₁ dhe *shtroj*₂ nga shterroj etj.

Si rrjedhim, kemi jo vetëm çifte homonimesh, por edhe grupe me 3 homonime: *lesë*₁ branë, *lesë*₂ kopan, *lesë*₃ xhufka në rroba; *korë*₁ krodhë, *korë*₂ ikonë, *korë*₃ afat, brezni; *llajë*₁-*llajë*₂-*llajë*₃; dhe nganjëherë grupe të tërë: *makh*₁-*makh*₂-*makh*₃-*makh*₄; *pjekë*₁-*pjekë*₂-*pjekë*₃-*pjekë*₄; *kore*₁-*kore*₂-*kore*₃-*kore*₄-*kore*₅ (për kuptimet shih Fjalorin e gjuhës shqipe, 1954).

Kur përmenden fjalë nga dialekte të ndryshme dhe të gjuhës së përbashkët, ka rëndësi të vërehet se homonimia këtu është e mundshme, por jo gjithnjë ndeshet në të vërtetë. Kështu kemi fjalën *roman* si gjini të proçës dhe *roman* fjalë krahinore për shule, *brom* element në kimi dhe *brom* për koçan misri, *term* në shkencë dhe *term* për truall, *dans* për vallzim dhe *dans* një pjesë e mullirit etj. Është e vështirë t'i ndeshim këto çifte fjalësh bashkë në një kontekst ose në të njëjtën situatë të foluri. Prandaj dhe kur pasqyrohen në fjalor, nuk mund t'i quajmë homonime të vërteta, por vetëm homonime fiktive, fjalorësh; zor se mund të parashikohet nëse ato do të ndeshen në gjuhë vërtet si homonime. Në përgjithësi kjo duhet shtruar për të gjitha homonimet: homonimia e vërtetë lind atëherë, kur fjalët i përkasin shtresave të njejta ose të afërta të leksikut, kur janë të sferave të afërta dhe mund të përdoren në të njëjtin kontekst ose situatë të foluri.

Një grup tjetër homonimesh lind gjatë huazimit nga gjuhët e tjera. Fjala e re që hyn, gjen në shqipen një fjalë tjetër, që tingëllon njësoj me të, sigurisht me një kuptim të ndryshëm; nga ana tjetër, fjalët e huazuara në pjesën më të madhe i nënshtrohen ndryshimit në bazë të shqipes.

Ndarja e homonimeve për shkak të huazimit mund të bëhet sipas buri-meve të tyre dhe marrëdhënieve me fjalët shqipe. Një pjesë e huazimeve, me ndryshimet përkatëse fonetike, del homonime me fjalë të shqipes (ose të asimiluara prej saj me kohë), p.sh. fjala *bar* për bimën e luadheve del homonim me *bar* për kafene (nga angl.) dhe *bar* fjalë speciale për precision atmosferik (nga greq.); e me radhë: *gaz* për gëzim dhe *gaz* për trup i gaztë; *haps* për çelës dhe *haps* i burgosur nga turq.; *kalori*₁ për kavaleri dhe *kalori*₂ për njësi nxehësie (lat.); *emër*₁ dhe *emër*₂ nga turq *emir* për urdhër; *dukë*₁ për pamje dhe *dukë*₂ si titull nga it.; *darë*₁ dhe *darë*₂ nga it. tara (atje po ashtu nga arab.); *çun*₁ djali dhe *çun*₂ varkë peshkimi (nga bullg.); *arshin*₁ për rrëshirë dhe *arshin*₂ si masë (nga rus.); *dekan*₁ për i vdekur dhe *dekan*₂ drejtues i fakultetit (lat.); *çam* banor i Çamërisë dhe *çam*₂ bredh nga turq.; *lamë*₁ për lëm dhe *lamë*₂ një kafshë (nga spanj.); *mat*₁ buzë lumi dhe *mat*₂ në shah (nga pers.); *helm*₁ dhe *helm*₂ helmetë (gjerm.); *elbëzë*₁ për elbth dhe *elbëzë*₂ nga turq. elbaze etj.

Ngjet që dalin homonime në shqipen dhe dy fjalë të huazuara ndërmjet tyre. Këto mund të jenë, së pari, fjalë që kanë qenë homonime edhe në gjuhën nga janë marrë: *kosë*₁ -*kosë*₂ (bishtalec) nga sllav.; *boks*₁ në sport, *boks*₂ vend në stallë dhe *boks*₃ një lloj lëkure nga anglishtja; *tabak*₁ lëkuraxhi, *tabak*₂ fije letër, *bel*₁ mez dhe *bel*₂ lopatë, *divan*₁ minder dhe *divan*₂ përmbledhje letrare nga turqishtja etj. Së dyti, fjalë të ardhura nga po ajo gjuhë, por pasi kanë pësuar ndryshimet përkatëse, në shqip

kanë dalë homonime: lat. *dictare* dhe *detegere* me një zhvillim të gjatë kanë dhënë në shqipen dy homonimet *diktoj₁* pikas, zbuloj dhe *diktoj₂* bëj diktim, ja nënshtroj diktatit; *anemi₁* qerthull dhe *anemi₂* pagjakësi (nga greq.); nga turqishtja: *bojë₁* shtat dhe *bojë₂* ngjyrë (nga *boy* dhe *bo-ya*), *ashik₁* 'kockë e gjurit dhe *ashik₂* dashnor, *hase₁* kambrik dhe *hase₂* bukë e bardhë, *kafaz₁* thurimë dhe *kafaz₂* roje (kafes-kavas), *çirak₁* ndihmës dhe *çirak₂* lloj kandili (çirak-çirakma); *kandër₁* insekt dhe *kandër₂* okatare nga greq., *fokë₁* një kafshë dhe *fokë₂* të kuqtë e madh, nga it. etj. Së treti, fjalë të ardhura nga gjuhë të ndryshme dhe që në shqip kanë dalë homonime: *dragë* ortek (nga sllav.) dhe *dragë* një makineri nga fr. *drague*; *ar₁* flori dhe *ar₂* masë toke nga fr. *are*; *gradë₁* nga it. dhe *gradë₂* çerdhe, trinë nga sllav.; *myshk₁* bimë nga it. muschio dhe *myshk₂* erë e mirë nga pers. *mushk*; *pol₁* në gjeografi nga it. dhe *pol₂* çivi e derës nga sllav.; *robinjë₁* akasje nga it. dhe *robinjë₂* sllave; *çelnik₁* për celik nga turq. dhe *çelnik₂* stanar nga bullg.; *dado* për tajë nga turq. dhe *dado₂* vidë nga it.; *fishë₁*-*fishë₂*; *gram₁*-*gram₂*-*gram₃* etj.; disa raste më të ndërlikuara: *shpuzë₁*-*shpuzë₂*; *paralolë₁*-*paralolë₂* *fugë₁*-*fugë₂*-*fugë₃* etj.

Lindja e homonimeve për shkak të huazimeve është një arsye e jashtme. Si ngjet që gjuha e merr një fjalë, megjithëse ajo ka vetë një kompleks tingujsh të njëjtë? Me sa duket, kjo vjen nga që homonimia lind kryesisht mbi bazën e brendëshme, mbi këtë bazë ajo pajtohet edhe me homoniminë për shkaqe të jashtme dhe mban po të njëjtin qëndrim si dhe ndaj homonimeve të veta.

Një rrugë tjetër, e brendëshme, e lindjes së homonimeve është fjalëformimi. Me që këtu kemi të bëjmë me fjalë të prejardhura, mund të quheshin këto edhe homonime të prejardhura.

Rastin më të qartë e përfaqësojnë homonimet e prejardhura nga rrënjë ose fjalë homonime, pra nga foljet homonime *pjek* (bukën etj.) dhe *pjek* (takohem, prek) edhe emrat foljorë *pjekje₁*-*pjekje₂* do të jenë homonimikë; po kështu ngjet me fjalët e prejardhura nga foljet *vloj* (valo, zje) dhe *vloj* fejoj, nga do të kemi: *vlim₁*-*vlim₂*, *i vluar₁*-*i vluar₂*; nga *end* (bëj pëlhurë), *end* (çel lule) dhe *end* (për mizat) kemi homonimet e prejardhura *endëz₁* (pëlhurë merimange), *endëz₂* (lule pemësh) dhe *endëz₃* (larvë fluturash), *endës₁* (vektari) -*endës₂* (mugulli, sythi); nga foljet *diktoj₁*-*diktoj₂* kemi emrat *diktim₁*-*diktim₂*; *rreshtoj₁* (radhis) dhe *rreshtoj₂* (arrestoj) japin *rreshtim₂*-*rreshtim₁* etj.

Grupin më të madh në homonimet e prejardhura e përbëjnë ato, që vijnë nga rrënjë krejt të ndryshme. Ndër emrat kemi p.sh. *pasanik₁* për pasues dhe *pasanik* për njeriun e pasur; *kamje₁* për perusti nga *kambë* dhe *kamje₂* për pasuri nga *kam*; *shpatore₁* për një bimë që nga forma e gjetheve si shpatë ka marrë emrin dhe *shpatore* për shpatë i vogël, *faqore₁* pagure si zgjerim me *-ore* i fjalës *faqe* dhe *faqore₂* nga *faqell¹*); *fajkore₁* lloj barke nga *fajkë* dhe *fajkore₂* lidhur me *fajkua*); *rrojë₁* nga *rroj* dhe *rrojë₂* nga *ruaj*; *doçkë₁* lodra doçe dhe *doçkë₂* zvogëluese për *-dërë*; *bunishtë₁* stan në mal dhe *bunishtë₂* tokë e butë (ndoshta lidhur me foljet *buj-bunitem*); *rrashinë₁* nga rrafsh dhe *rrashinë₂* për kësulë etj. Nga foljet: *gjatoj₁* zgjatoj dhe *gjatoj₂* nga gjah; *gjëm₁* lidhur me *gjëmë* dhe *gjëmjoj₂* nga gjurmtoj), *rendë₁* radhis nga *rend* dhe *rendoj₂* grij me rende,

16) Shih E. Çabej, *Studime rreth etimologjisë së gjuhës shqipe*, VI, "Bul. Un. Sht. të Tiranës, S. Shk. Shoq." 1962, N. 1, f. 86.

17) *Po aty*, f. 84.

18) Shih E. Çabej, *Studime rreth etimologjisë së gjuhës shqipe*, VIII, "Bul. Un. Sht. të Tiranës, S. Shk. Shoq." 1962, N. 3, f. 68.

tek fjalori i K. Kristoforidhit¹⁹) gjejmë dhe *rendoj*₃ për rend, vrapoj; *laroj*₁ bëj lara-lara dhe *laroj*₂ lëvroj; të pjesëshme: *përhihet*₁ bëhet me hi dhe *përhihet*₂ (më) më bëhet si hije, etj.

Mbiemrat e paktë homonimë të gjuhës shqipe gjenden kryesisht në këtë grup: *hir-sh*₁ për i hirshëm nga *hir* dhe *hirosh*₂ i hirtë nga *hi*; *i paditur*₁ nga folja *padis* dhe *i paditur*₂ për atë që nuk di; *i rruar*₁ për atë që është rrojtur dhe *i rruar*₂ për njeriun që rron mjaft; *i ndermë*₁ për i ndershëm dhe *i ndermë*₃ për i nderur, i varur; *i marrë*₁ për i marrosur dhe *i marrë*₂ nga folja *marr*; *i gjashëm*₁ për i pasur dhe *i gjashëm*₂ për *i ngjashëm*; *i larë*₁ nga folja *laj* dhe *i larë*₂ për *i larmë*; *zanore*₁ që u përket zanave dhe *zanore*₂ i zëshëm, i zërit; *i parë*₁ nga folja *shoh* dhe *i parë*₂ si numror rrjeshtor etj.

Nga shembujt del se ngranjëherë çiftin homonimik e përbëjnë një fjalë e prejardhur me një fjalë, që në planin sinkronik nuk mund të zërthehet në morfemë rrënjë dhe në afiksa; p.sh. *dredhës* për tehri lidhet me foljen *dredh*, ndërsa *dredhëz* për një bimë del si fjalë e parme; *fikës* nga folja *fik* dhe *fikës* bengu, e njëjtë me *fikë*, *helmzë* nga *lemzë* dhe *helmzë* për kushtor etj.

Mund të ngjallë veçanërisht diskutime mundësia e lindjes së homonimeve nga po ajo rrënjë. Vëzhgimet mbi disa shembuj të gjuhës shqipe na bëjnë të pranojmë mendimin se ka mundësi të lindin homonime edhe nga e njëjta rrënjë. Kjo bëhet e mundur nga disa faktorë. Së pari, meqë në gjuhën shqipe kemi parashtesa dhe prapashtesa homonimike, atëherë këta afiksa, duke u bashkuar me po atë rrënjë, do të na japin dy fjalë të ndryshme, p.sh. *arrëz* për pyll me *arra* dhe *arrëz* për arrçin e zverkut kanë po atë rrënjë *arrë*, megjithatë nuk na duket se mund të quhet zhvillim kuptimor i po asaj fjalë (vështirë se mund të gjenden shembuj të tjerë, ku të lidheshin bashkë në një fjalë dy kuptime të tilla, të lindura nga përdorimi i po kësaj prapashtese). Mbetet t'i quajmë dy fjalë të ndryshme homonime dhe homoniminë e tyre ta shpjegojmë me homoniminë e prapashtesave. Së dyti fjalët e prejardhura mund të kenë formën e brendëshme të ndryshme, p.sh. *ferrac*₁ për një bimë dhe *ferrac*₂ për mulli me një mokërr, nga ana thjesht formale mund të ndaheshin në morfema, mirëpo për *ferrac*₂ është dashtur një rrugë më e gjatë dhe e tërthortë²⁰) për të arritur në formën e sotme dhe prandaj sot nuk mund të themi se kjo fjalë është formuar thjesht nga *ferrë+ac*, nuk do të dilte i qartë ndërtimi i brendshëm dhe kuptimi i fjalës, ndërsa për *ferrac*₁ një zërthim i tillë është i qartë. Së treti, homonimet e prejardhura mund të lindin në pjesë të ndryshme të ligjeratës (pra si homonime leksiko-gramatikore), p.sh. nga emri *grykë* është formuar mbiemri *grykës*₁ për hamës, llupës me substantivimin e mëtejshëm, ndërsa emri *grykës* shënon një lloj jeleku grash. Bashkëveprimi i këtyre tre faktorëve ka sjellë lindjen e disa homonimeve të prejardhura nga po ajo rrënjë e parë: *fillore*₁ shkolla fillore dhe *fillore*₂ lloj velenxe me thekë, *dorak*₁ për dorezë dhe *dorak*₂ për dorëçung; *fushore*₁ fushë e vogël dhe *fushore*₂ si mbiemër; *beronjë*₁ për një gjarpër dhe *beronjë*₂ për një shkurre; *mashkullore*₁ grua si burrë dhe *mashkullore*₂ gjinia mashkullore në gramatikë; *mesore*₁ në gramatikë dhe *mesore*₂ në gjeometri; *ditor*₁ regjistër dhe *ditor*₂ dita para një feste; *ditar*₁ fletore shënimesh dhe *ditar*₂ masa e lërimit në një ditë; *fillak*₁ dru i drejtë dhe *fillak*₂ velenxë etj.

19) K. Kristoforidhi, *Fjalori shqip-greqisht*, 1961, f. 297.

20) Shih E. Çabej, *Studime rreth etimologjisë së gjuhës shqipe*, VI, — "Bul. Un. Sht. të Tiranës, S. Shk. Shoq.", 1962 N. 1, f. 94.

Dallimi i homonimeve, që lindin gjatë fjalëformimit, shtron kërkesën s për një analizë të përpiktë dhe të drejtë morfologjike të fjalëve nga pikpamja e sistemit të sotëm të gjuhës shqipe, nga pikpamja e modeleve dhe rregullave të sotme të fjalëformimit në gjuhën shqipe. Kështu p.sh. fjalën *thekës*₁ për shenjë mbi fjalët, lidhur me *theksim*, *theksoj*, nuk mund ta ndajmë në *thek*+*ës*, ndërsa *thekës*₂ për një vegël për të thekur mund ta ndajmë, si rrjedhim, kemi dy homonime e jo një fjalë me dy kuptime. Kërkesa e dytë, që shtrohet, i përket shtresës leksikore, në të cilën bëjnë pjesë fjalët që analizohen. Ka mundësi që në gjuhë nga i njëjti brumë të formohen dy-tre fjalë të ndryshme në periudha të ndryshme, në sfera e fusha të largëta të degëve të shkencës e dijes, që s'kanë të bëjnë me njera tjetrën, apo në stile të ndryshme të gjuhës. E kundërta ngjet, në rast se fjalët janë ndër-tuar mbi të njëjtën figurë; atëhere në ndeshjen e tyre të parë këto fjalë do të merren si kuptime të po asaj fjale, dhe jo si dy fjalë të veçanta homonime. Kështu p.sh. *kryqëzat* për të dy shpatullat e prasmë të samarit dhe *kryqëzat* për kërbishtet, kryqet, shënojnë sende nga fusha të ndryshme, por nga forma e tyre të krahasueshme, si rrjedhim mund të merren si kuptime të një fjale, gjë kjo që mund të thuhet në përgjithësi për kuptimet e ndryshme të emrave zvogëlues (krahaso 5-6 kuptimet e fjalës *gojëz*). Shembëll i rastit të kundërt mund të na shërbejnë *distik*₁ për një varg të vjetër në poezi dhe *distik*₂ për lloj elbi (japim këtë shembëll jo nga brumi i shqipes, meqë në Fjalorin e gjuhës shqipe të vitit 1954 i gjejmë si një fjalë) mendojmë se kemi dy homonime, me që ndërtimi i fjalëve është bërë mbi një bazë jo të afërt, me një formë të brendëshme të ndryshme, me motivim të ndryshëm semantik; i njëjti arsyezim vlen për *idiotizëm*₁ për fjalë a frazë të veçanta dhe *idiotizëm*₂ për diçka idiote.

Një rast të veçantë, që nuk lidhet me fjalëformimin drejtpërdrejt, kemi tek foljet homonime vetëm në formën pësore (homonime të pjesëshme). Nga *fshij* dhe *fshih* format pësore përputhen: *fshihem*₁-*fshihem*₂; nga *ftoj* dhe *ftoh* kemi *ftohem*₁-*ftohem*₂; nga *ze* dhe *ziej* kemi *zihem*₁-*zihem*₂; nga *ngre* dhe *ngrij* kemi *ngrihem*₁-*ngrihem*₂; nga *shij* dhe *shoh* kemi *shihet*₁-*shihet*₂; nga *zgjedh* e *zgjidh* kemi *zgjidhet*₁-*zgjidhet*₂; nga *rri* e *rrah* kemi *rrihet*₁-*rrihet*₂ etj.

Mundësia e lindjes së homonimeve gjatë fjalëformimit, me sa duket, shpjgohet me faktin që pasuria e morfemave produktive në gjuhën shqipe, sado e madhe që është, ka një farë kufiri, ndërsa ndërtimi i fjalëve të reja prej tyre kufizohet nga një varg rregullash e modelesh. Si rrjedhim, kombinimet e morfemave të ndryshme ndonjëherë edhe mund të sjellin në të njëjtin përfundim, në dy fjalë të ndryshme, por që tingëllojnë njësoj. Po të zgjerohet më tej ky përfundim, në formë të përgjithëshme mund të thuhet se homonimia bëhet e mundur në gjuhë për shkak të numurit të kufizuar të tingujve të gjuhës dhe të mundësiye të bashkimit të tyre në gjuhë, bashkim që përcaktohet historikisht dhe jo thjesht sipas logjikës së ndërtimit të një sistemi artificial, si janë gjuhët e tipit të esperantos, ku homonimia e vitohet. Sa më pak tinguj të ketë fjala, aq më i vogël është numuri i mundshëm i kombinimeve të tyre, për pasojë, sa më e shkurtër të jetë fjala, aq më lehtë mund të ketë një homonim në gjuhë.

Rruga e fundit që përmendëm, është zbrëthimi i polisemisë Mundësia e lindjes së homonimisë në këtë rrugë përbën një çështje mjaft të diskutueshme edhe për gjuhët e tjera. Një trajtim teorik i gjithanshëm i problemit, një shoshitje e vështrim kritik i pikpamjeve të ndryshme, do të na largonin mjaft nga fusha e gjuhës shqipe, prandaj mbi bazën e shembujve të shqipes do të preken disa nga veçoritë e saj në këtë drejtim.

Meqë zbrëthimi i polisemisë në homonimi është në të vërtetë çështja e marrëdhënieve të polisemisë me homoniminë, dël e nevojshme të ceket dikë rreth polisemisë së shqipes. Kur shqyrtohet ndërtimi i strukturës kuptimore të fjalëve në shqipen, bie në sy para së gjithash një gjë: kufijtë e polisemisë në shqipen janë mjaft të gjerë, e njëjta fjalë mund të përfshijë disa kuptime që shpesh duken të laigëta, si të thuash, veshja materiale e fjalës është mjaft elastike. Këtë e tregojnë më së miri p.sh. emrat e pjesëve të trupit (*kohë, gjuhë, dorë, sy* etj.) me strukturën e ndërlikuar kuptimore dhe me pasurinë e madhe të frazeologjisë, ose foljet si *bie, jap, bëj, fus, gjej* etj.

Për shkoqitjen e problemit kërkohet të përcaktohet në vija të përgjithshme një nocion themelor i polisemisë, si është *kuptimi leksikor i fjalës*. Kuptimi leksikor i fjalës është tërësia e varianteve të saj leksiko-semantikore. Në të bashkëveprojnë njëkohësisht tre faktorë: realiteti objektiv, pra lidhja me sendet, realitet (kjo lidhje në planin historik është edhe lidhje me historinë e popullit në kuptimin e gjerë të fjalës); të menduarit, veprimtaria e të cilit ka për qëllim njohjen e realitetit objektiv, rrjedh në formën e nocioneve dhe realizohet me mjetet e gjuhës; së fundi sistemi i gjuhës, ku në fushën e leksikut marrëdhëniet e brendshme të elementëve të këtij sistemi krijohen historikisht por në fund të fundit bazohen në dy faktorët e parë). Në çdo etapë të caktuar (dhe në planin sinkronik) kuptimi leksikor i fjalës mund të lidhet me një nocion themelor, ndërsa variantet leksiko-semantikore të fjalës përfaqësojnë zhvillimin dhe ndryshimin e këtij nocioni themelor. Këtë nocion themelor mund ta quanim edhe kuptim stumbullar. Kuptimet e tjerë, variantet e veçantë leksiko-semantikore të fjalës mund të jenë më larg ose më afër me njeri tjetrin, kjo gjë ndryshon vazhdimisht gjatë procesit të zhvillimit kuptimor të fjalës, por lidhen si një e tërë e vetme rreth kuptimit themelor.

I afrohemi kështu shpjegimit të vetë polisemisë. Polisemi kemi kur variantet leksiko-semantikore të një fjale formojnë një kuptim leksikor të vetëm, kur lidhen në realitetin objektiv dhe në nocionet e të menduarit si pasqyrim i këtij realiteti, gjë që çfaqet edhe në sistemin e gjuhës: këto variante paraqesin të njëjtën fjalë nga ana tingëllore, në lidhjet e saj morfologjike e sintaktikore, të fjalëformimit dhe në paradigmen e saj, në lidhjet e ndryshme leksikore.

E kundërta e kësaj do të ishte homonimia: njeri nga variantet leksiko-semantikore të fjalës, për një arsye ose tjetër nuk ruan më po atë lidhje sendore në realitetin objektiv, prandaj përfaqëson një nocion të ri të parvarur edhe në të menduar, në ndërgjegjen e folësit, e si rrjedhim, edhe në sistemin gjuhësor do të ketë lidhje të reja, do të jetë vetë tashmë një kuptim stumbullar si qendër e re fjalëformimi, me lidhje të reja leksikore, frazeologjike etj.

Homonimia është një fenomen, që i përket kryesisht sinkronisë. Marrëdhëniet e saj me poliseminë mund të analizohen drejt në planin sinkronik. Në këtë plan, parimi etimologjik për dallimin e homonimeve, që u theksua më lart, këtu nuk mund të lozë rolin vendimtar, ai mund të jetë vetëm një parim ndihmës, që shërben atëhere, kur gjurmët e zhvillimit historik të fjalës janë të ndjeshme akoma edhe sot, nuk janë fshirë përfundimisht në sistemin e sotëm të leksikut. Një figurë e disa shekujve më parë përshëmbëll, nuk mund të shërbejë si argument përfundimtar sot, kur gjurmët e saj janë fshirë prej kohësh. Fjala *feçkë*, për zgjatim turiri dhe

*feçkë*₂ për vajzë e vogël dhe si sharje, kanë lindur mbi të njëjtën figurë nga ana etimologjike²²⁾, por kjo s'ka të bëjë me gjuhën e gjallë të sotme.

Cili do të ishte atëhere parimi themelor për dallimin në praktikë të homonimisë nga polisemia? Mendojmë se, si parim themelor për analizën e çdo rasti të veçantë, mund të shërbente ky: *vendi i fjalës në sistemin e sotëm të gjuhës shqipe*. Ky vend përcaktohet jo vetëm nga lidhjet etimologjike të fjalëve, por edhe nga lidhjet e sotme me sendet dhe nocionet, nga lidhjet me vargjet e fjalëformimit, nga lidhjet leksikore (antonimike, sinonimike, të fushës semantike, frazeologjike), nga sferat dhe shtresa stilistike e përdorimit, nga lidhjet morfologjike e sintaktike. Siç shihet, këtu përfshihet gjithçka u tha më lart për rrugët e tjera të veçanta të lindjes së homonimeve.

Për ta sqaruar konkretisht këtë parim, po analizojmë disa shembuj. Janë marrë shembujt nga Fjalori i gjuhës shqipe i vitit 1954, meqë në të kemi rezultatet më të mira të gjithë punës për zbërthimin e strukturës kuptimore të fjalës shqipe, në të janë marrë parasysh pjesa më e madhe e kërkesave që u shtruan sipër dhe prandaj janë shmangur paraqitjet jo të përpikta, që viheshin re në fjalorët e mëparshëm. Mjafton të shënojmë, se në mjaft fjalorë të mëparshëm homonimet *bli*₁ dhe *bli*₂ kanë qenë dhënë si kuptime të një fjale²³⁾, po ashtu homonimet *shqipe*₁ për shqiponjë dhe *shqipe*₂ për gjuhën shqipe jepeshin si raste polisemie²⁴⁾. Në Fjalorin e gjuhës shqipe, te fjala *shpik* në formën pësore *shpikem* jepen: "u *shpik* *kazani*, u bë me vrma; "dhe" *fig. u a*, s'më mbeti më pare në xhep, u shkunda nga paret". Për kuptimin e parë nuk jepet gjë në trajtën veprorë të foljes ndonëse ky kuptim s'ka si të lindë pa një bazë në formën veprorë, rrjedhimisht forma veprorë *shpik* e ka këtë kuptim, gjë që mund të dëshmohet. Kuptimi i dhënë si figurativ i korespondon në formën veprorë kuptimit të parë: "e pi gjer në fund, e shkund". Në se do të kërkonim ndonjë nga lidhjet semantike të kësaj folje, do të gjenim se kuptimi vepror *shpik* për çkolis ka një antonim në foljen *pik*: ze vrimën e një ene me kallaj. Ndërsa kuptimi tjetër (e pi gjer në fund, e shkund) nuk ka antonim. Me sa del, kjo nuk është e rastit. Folja *shpik*₁ (e pi gjer në fund) është formuar nga emri *pikë*, kurse folja *shpik*₂ (çkolis) është formuar nga folja *pik*. Prandaj kemi të bëjmë me dy fjalë, me dy homonime dhe jo me kuptimet e një fjale të vetme. Në fjalën *njësi* jepen si dy kuptime: 1. njësi; 2. të kulloturit e gjësë së gjallë me radhë. Kuptimi i parë gjen trajtën koresponduese në toskërishten, ndërsa i dyti jo. Kjo jo sepse fjala *njësi* ka patur zhvillim të ndryshëm në të dy dialektet, po sepse *njësi* është fjalë e kulturës, e librave, e krijuar sipas modelit të një serë fjalëve të tjera të kësaj natyre (kr. madhësi, bashkësi etj.), e një sferë krejt të largët nga *njësi*₂, e ndërtuar nga populli. Tek folja *piskas* gjejmë dy kuptime: 1. bërtas, sokëllas; 2. stërpik. Për të parën kemi emrin *piskamë*, për të dytin *piskatë*, sepse kemi dy folje të ndryshme homonime (e para ndoshta sllav.). Tek folja *çap* janë dhënë si kuptime të saja: 1. përtyp, përçap (bukën); 2. punoj tokën me çapë, e shkrif; 3. *fint*. eci, vete. Nga ana semantike nuk ka shumë të ngjarë të gjendet lidhja e të tre kuptimeve në një fjalë të vetme; shtrirja dialektore

22) Shih E. Cabej, *Studime rreth etimologjisë së gjuhës shqipe*, VI, "Bul. Un. Sht. të Tiranës, S. Shk. Shoq.", 1962, N. 1, f. 89.

23) Tek fjalorët: A. Leotti, *Dizionario albanese-italiano*, Roma, 1937; F. Cordignano, *Dizionario albanese-italiano*, Milano, 1934; S. Mann, *An historical albanian-english dictionary*, 1948; G. Weigand, *Albanesisch-deutsches und deutsches-albanesisch Wörterbuch*, Leipzig, 1944; *Fjaluer i Rii i Shcypës*, Shkodër, 1908.

24) Tek fjalorët e A. Leotti-t, F. Cordignano-s dhe *Fjaluer i Rii i Shcypës*; Shkodër, 1908.

e tyre është e ndryshme. Çap_1 përtyp, përçap përdoret në një krahinë të kufizuar dhe lidhet me emrin *çapë* kafshatë. Çap_2 për punoj me *çapë* është. me sa duket, një me *capë* dhe lidhet me *capoj-çapoj, capë-çapë* etj.; etimologjikisht këtu mund të kemi një fjalë të burimit tjetër (sllav.). Çap_3 është folje jo kalimtare, ka një varg tjetër fjalëformimi dhe të një modeli të ndryshëm: *çap* (emër), *çapitem, çapthi*.

Shembujt e dhënë më lart i përkasin homonimeve, që nuk vijnë nga një rrënjë ose nga i njëjti formim e nuk mund të shërbejnë për të sqaruar marrëdhëniet e homonimisë me poliseminë. U sollën vetëm për të sqaruar se ç'kuptohet me analizë të fjalës, për të caktuar vendin e saj në sistemin e sotëm të gjuhës shqipe.

Problematika e diskutueshme dhe e ndërlikuar e marrëdhënieve të homonimisë me poliseminë del në pah, kur kemi të bëjmë jo me fjalë të ndryshme, por me një fjalë të vetme dhe kuptimet e saj. Një pjesë e studjuesve e mohojnë mundësinë e zbrërthimit të një fjale polisemike në dy-tre fjalë homonime, polisemia dhe homonimia nuk kanë asnjë lidhje²⁵). Përsa i përket shqipes, nga vëzhgimet mbi leksikon e saj, del se është i drejtë mendimi, që nga *polisemia ka mundësi të lindë në disa raste homonimia*.

Fjalët *shalë*₁ për pjesë të trupit dhe *shalë*₂ për një pajim lëkure, që i vihet kafshës në kurriz, pa dyshim kanë të njëjtin burim etimologjik. Megjithatë sot ato shënojnë dy objekte, dy realitë të ndryshme, në ndërgjegjen e folësve merren si dy fjalë, e dyta është zhvilluar më tej dhe shënon një pjesë të biçikletës e motoçikletës, ndërsa në sistemin e gjuhës sillen ndryshe. E para e bën shumësin *shalët* e përdoret më shpesh në shumës, lidhet me një varg të vetin të fjalëformimit: *shalakuq, shalëgjatë, shalështrembër*, ka fituar edhe një nuancë emocionale e nuk është fjalë thjesht neutrale; ndërsa e dyta e bën shumësin *shalat*, lidhet me vargun *shatoj, shaluar*, nuk ka ndonjë nuancë emocionale. Kemi kështu jo një kuptim themelor strumbullar me variantet e tija leksiko-semantikore, por dy kuptime të shkëputura njeri nga tjetri, që janë qëndra të dy vargjeve të ndryshme fjalëformimi etj. E njëjta gjë vlen për shembujt e më poshtëm. Nga emri i një gjelle e byreku *fli* u zhvillua kuptimi kurban e theror në përgjithësi. Mirëpo ndërsa gjella mbeti e kufizuar dhe mund të harrohet shpejt fare, kuptimi tjetër mori udhë, i përket gjuhës së përbashkët, është bërë produktiv (*flijoj, flijohem, flijim*). Mendohet se folja *kallëzoi*₁ për tregoj mund të ketë qenë variant leksiko-semantikor i *kallëzoi*₂, nxjerr kallëz, megjithatë ato sot janë homonime të pjesëshme; *kallëzoi*₁ është folje kalimtare, e dyta jo kalimtare, për më tepër në vetën e parë nuk ka pse të përdoret (me të drejtë në Fjalorin e gjuhës shqipe jepet në formën përfaqësuese *kallëzon*). E para ka një varg të fjalëformimit: *kallëzim kallëzimitar, kallëzues*. Po të pranoheshin këto dy folje si një e vetme, duhet të pranohet edhe që *kallëzore*₁ për rasën akuzative dhe *kallëzore*₂ për mbledhësen e kallëzave, janë një fjalë, ndërsa dihet mirë, që këto dy fjalë kanë lindur pavarësisht nga njëra tjetra, në rrugë e në sfera krejt të largëta. Emri *cup*₁ për sup dhe *cup*₂ ndajfolje për tek, jo çift, nga ana etimologjike duhet të jenë e njëjta fjalë;²⁶) kurse sot ato lidhen me sende krejt të ndryshme të

25) Kohët e fundit ky mendim është formuluar në mënyrën më të mprehtë nga V.I. Abajev në artikullin «() подает омономим в словаре» në «Вопросы языкознания», 1957, Nr. 3. Rreth tij u zhvillua një diskutim i gjërë në faqet e asaj reviste dhe pati mjaft jehonë siç e dëshmon V. Rudeanu "Omonimele si practica lexicografica in discutit a lingvistilor Sovietici" në Limba Romina, 1959, N. 5.

26) Shih E. Çabej, *Studime rreth etimologjisë së gjuhës shqipe*, II, "Bul. Un. Sht. të Tiranës", 1964, N. 1, f. 69.

realitetit, për pasojë në të menduar përfaqësojnë dy nocione që s'kanë të bëjnë aspak, në ndërgjegjen e folësve nuk lidhen më me njera tjetrën. Në gjuhë shkëputja e këyre dy fjalëve, nga të cilat e dyta dikur duhet të ketë qenë një variant leksiko-semanticor i të parës, pasqyrohet në faktin se e dyta është ndajfolje, pra ka marrëdhënie të tjera morfologjike e sintaktike nga emri *cup*, për më tepër në Shkodër dëgjohet qartë *cub* e jo *cup*.

Shkaqet që njeri nga variantet leksiko-semanticore të fjalës shkëputet si fjalë më vehte, mund të jenë të ndryshme. Nganjëherë mund të ketë rënë hallka e ndërmjetme, që i lidhte dy kuptimet. Fjala *gjellë*₁ për gatim lidhet historikisht me *gjellë*₂ për jetë, mirëpo sot këto kuptime nuk kanë diçka të ndërmjetme që t'i bashkonte. Mund t'i quajmë homonime historike, me që kemi një kuptim të gjallë të sotëm dhe një tjetër, që i përket vetëm historisë. Fjala *kafshë* sot përdoret vetëm për shtazë, kuptimi i vjetër *gjë* i përket historisë. Kjo sepse, si e tregojnë kompozitat *gjëkafshë*, *gjësendi* (pa element lidhës, të një tipi të vjetër, ku ndesheshin fjalët sinonime për të njëjtin nocion), sinonimi i saj *gjë* doli më i qëndrueshëm, ruajtë kuptimin e përgjithshëm me të gjitha nuancat, ndërsa të tjerat i detyroi të ngushtohen e të specifikoohen.

Ka të ngjarë, që shkëputja të bëhet për shkak të zhvillimit krejt të ndryshëm në dialektet e ndryshme, kaq sa mbas një periudhe të gjatë kuptimet e dikurshme ndeshen si homonime. Fjala *çikë*₁ për dërm, copë e vogël, me gjithë variantet e sotme "xixë, rreze, shkëndijë, gjerbë, pikë", etj., dikur mund të ketë patur dhe variantin *çikë*₂ vajzë, gocë. Por *çikë*₂ u zhvillua dhe mori kuptimin e sotëm vetëm në një dialekt, jo në të gjithë gjuhën shqipe, me sa duket, atje i përjashtoi dhe variantet e tjerë leksiko-semanticore e mbeti si një fjalë më vehte, me kuptim të pavarur. Natyrisht, kjo nuk do të thotë se çdo kuptim i veçantë i fjalës, që gjendet në dialektet, përfaqëson një fjalë të re. Është i nevojshëm në këtë drejtim një gjurmim sa më i plotë i fjalëve, në mënyrë që të mos coptohen, vetëm për mungesë të njohurive të përpikta për to.

Në raste të rralla shkëputja e një varianti ngjet, kur ai përdoret si term në një fushë të veçantë. Nganjëherë në bazë të termit të ri vihet një shenjë jo e rëndësishme, jo esenciale, jo e përherëshme, ose thjesht kemi kalkim e nga gjuhët e huaja. Kjo lidhje e sipërfaqëshme dhe e cekët është e paqëndrueshme, këputet lehtë dhe mund të sjellë që termi të shkëputet si homonim. Mendojmë se kështu ka ngjarë, p.sh. me *thekës*₁ dhe *thekës*₂ ose me *zgjedhoj* në gramatikë dhe *zgjedhej* vë nën *zgjedhë* etj.

Së fundi, mund të lozin rol edhe faktorë të jashtëm. Fjala *bëbe*₁ për foshnjë dhe *bëbe*₂ për beben e syrit janë me të njëjtin burim etimologjik dhe zërthimi i tyre në dy fjalë është bërë jashtë gjuhës shqipe²⁷⁾. E njëjta gjë vlen për *bankë*₁ institucion financiar dhe *bankë*₂ tryezë e nxënësit.

Mund të huazohet një fjalë po nga po ai burim, ose nga gjuhë të të njëjtit grup, dy herë, në dy epoka të ndryshme, në sfera, stile e rrugë të ndryshme, për nevoja shumë të largëta të gjuhës. Në këto raste flitet në gjuhën shqipe për homonimi, sepse ajo që mund të jetë një zhvillim i natyreshmë i kuptimeve në gjuhët nga merret fjala, mund të mos përputhet me natyrën e shqipes. Nga lat. *aera* kemi fjalën e përgjithëshme të gjuhës *erë*₁ dhe tashti vonë kemi *erë*₂ për "epokë" vetëm në gjuhën e librave dhe të sferës shkollore (ndoshta nga it. ku është zhvillim i po asaj baze latine). Me të drejtë në Fjalorin e gjuhës shqipe janë ndarë si homonime dy fjalë të kësaj natyre *kuadër*₁-*kuadër*₂, ndërsa, na duket neve, e njëjta gjë vlen të bëhet për

27) Shih S. Ullmann, *Précis de Semantique française*, 2e ed., Berné, 1959, f. 223.

*etiketë*₁ si sjellje dhe *etiketë*₂ një letër që i ngjitet mallrave (nga ku sot kemi dhe: etiketoj, etiketim, i etiketuar). Nga fjalët që diskutohen edhe për gjuhët e tjera, po përmendim: *raketë*₁ për një mjet reaktiv dhe predhë e *raketë*₂ pallaskë për të lojtur pingpong; *legjendë* për gojzhanë dhe *legjendë* në hartë; *falangë* në anatomi dhe në histori; *disiplinë* në sjellje dhe si shkencë; *aksion* veprim dhe në financë një lloj çeku; *emisar* i dërguar dhe kanal kryesor; *notë* në mësim, muzikë dhe *notë* diplomatike etj.

Këto shkaqe të shkëputjes së një varianti leksiko-semantikor të fjalës në një fjalë më vehte, mund të shërbejnë si çelës për dallimin në praktikën leksikografike të polisemisë nga homonimia. Prandaj autorë të ndryshëm në artikujt e tyre²⁸⁾ përqëndrohen tek rënia e hallkës së ndërmjetme, që lidhte kuptimet e veçuara të fjalës, tek lindja e qendrave të reja fjalëformuese, të palidhura nga ana semantike, tek modelet e ndryshme të fjalëformimit, tek përkatësia në vargje të ndryshme sinonimesh, tek kondicionimi konstruktiv i kuptimit etj. Një pjesë tjetër e studjuesve nxjerrin në plan të parë motivimin thjesht semantik, gjë e domosdoshme në një analizë të tillë, por e pamjaftueshme, sepse shpesh mund të sjellë në zgjidhje subjektive të paqëndrueshme, të bazuara vetëm në intuitën gjuhësore të leksikografit. Të gjitha këto anë të veçanta duhet t'i nënshtrohen qëllimit të vetëm të përcaktimit të vendit të fjalës në sistemin e sotëm të gjuhës.

Në marrëdhëniet e polisemisë me homoniminë mund të ndeshet edhe drejtimi i kundërt: kalimi i homonimisë në polisemi, kontaminimi homonimik i fjalëve të ndryshme.

Nuk do ndalemi këtu hollësisht në kontaminimet homonimike dhe as në pasojat e zbrërthimit të fjalës në homonime.

Në këtë mënyrë, pasi kemi shqyrtuar rrugët e lindjes së homonimeve, mund t'i ndajmë homonimet leksikore në homonime etimologjike (duke përfshirë këtu dhe ato nga dialektet e huazimet), homonime të prejardhura (të lindura gjatë fjalëformimit) dhe homonime semantike (nga zbrërthimi i polisemisë), duke patur secili grup nëndarjet e veta. Megjithatë në çiftet dhe grupet e homonimeve shpesh bashkëveprojnë disa faktorë njëkohësisht. Veprimi i të gjithë këtyre faktorëve së bashku ka bërë, që në gjuhën shqipe të lindin jo pak çifte dhe grupe homonimesh. Kështu fjala turke *dokumə* mbas ndryshimit fonetik ka dhënë në shqipe *dok* për lloj stofi, fjala angleze *dock* ka hyrë pa ndonjë ndryshim *dek*₂ dhe që të dyja gjejnë një *dok*₃ në dialektet e shqipës për plis, popël; kurse *çek*₁ për banor i çekisë piqet me *çek*₂ (nga angl. *check*) dhe me *çek*₃ për ushqimin e bariut; një grup të tërë homonimesh paraqet kompleksi i tingujve *pendë*. Veç shembujve të sjellë deri tani, mund të jepen edhe një listë jo e shkurtër e homonimeve në shqipen.

Kur homonimet leksikore përputhen në të gjitha format e tyre gjatë ndryshimit sipas paradigme, atëhere janë homonime të plota leksikore. Kur nuk përputhen në një pjesë të formave, atëhere kemi homonime leksikore të pjesëshme. Kështu foljet *prek*₂-*prek*₂ janë homonime leksikore të pjesëshme. Homonime të pjesëshme janë zakonisht emrat e gjinivë të ndryshme, që përputhen në të pashquarën, p.sh. *li-ri* dhe *li-ja*, *uri-a* dhe *uri-u*, *brushtull-i* dhe *brushtull-a*, *cumër-i* dhe *cumër-a*, ose numuri shumësi i një emri me një-

28) Përmendim vetëm tre artikuj, nga numuri i madh i atyre, që i kushtohen këtij problemi: E.M. Галкина — Федорук, к вопросу об омонимии, në «Русский язык в школе»; 1954, № 3; Р. В. Виноградов, Об омонимии в смежных языках, në «Вопросы языкознания», 1960, N. 5; Paula Diaconescu, *Omonimia si polisemia*, në «Probleme de lingvistica generale», vol. I.

jësin e një tjetri: *herdhe*-ja dhe *herdhet*-t, *heqje*-a dhe *heqje*-t; *keç*-i dhe shumësi *keç-ër* nga *kaç* etj. Ndarja e homonimeve leksikore në të plota dhe të pjesëshme është një klasifikim në bazë të një shënje formale, prandaj nuk e cënon paraqitja e bërë deri tani.

3.

Një ndarje të dytë të madhe, pas homonimeve leksikore, përbëjnë homonimet leksiko-gramatikore.

Homonimet leksiko-gramatikore janë dy ose më shumë fjalë që tingëllojnë njësoj, kanë kuptime leksikore krejt të ndryshme dhe kuptime gramatikore të ndryshme. Këto homonime edhe kuptimet i kanë krejt të ndryshme, edhe u përkasin pjesëve të ndryshme të ligjeratës, p.sh. *qepa* emër dhe *qepa* folje, *kisha* emër dhe *kisha* folje, *pata* emër dhe *pata* folje, etj. Nga mjaft studjues këto quhen edhe homoforma.

Burimet e lindjes së homonimeve leksiko-gramatikore janë po ato, që pamë për homonimet leksikore. P.sh. me burim të largët etimologjik: *bashkë*₁ si emër dhe *bashkë*₂ si ndajfolje mendohet se rrjedhin nga dy rrënjë mjaft të largëta: *barshkë* dhe *baksk*²⁹⁾ gjatë fjalëformimit nga e njëjta rrënjë, me ndërtim të ndryshëm të brendshëm ose me morfema homonime: *përdhes*₁ emër i një sëmundje dhe *përdhes*₂ mbiemër; *kalore*₁ emër dhe *kalore*₂ = ndajfolje; etj. Nga polisemia këtu, së pari, kemi përdorimin e fjalës si një pjesë tjetër e ligjeratës, më vonë shkëputjen si pjesë e veçantë e ligjeratës dhe dalëngadalë humbjen edhe të çdo lidhje kuptimore. Kështu p.sh. kanë lindur pjesëzat *do*, *le*, *desh*, *dish*, lidhëza *kish*, parafrjalët *bri*, *falë*, ndajfolja *fill* etj., që dalin sot si homonime të fjalës, me të cilën kanë lidhje etimologjike.

Përgjithësisht ky është grupi ku vepron më tepër rasti e ku ka vlerë në shumë shkurtësia e fjalëve, si e tregojnë disa nga shembujt e shumtë: *dhe*₁ emër, *dhe*₂ lidhëz; (ti) *dhe*₃; *fik*₁ emër, *fik*₂ folje; *cok*₁ emër, *cok*₂ folje, *cok*₃ ndajfolje; *citë*₁ emër, *citë*₂ ndajfolje; *byr*₁ emër, *byr*₂ folje, *breth*₁ emër, *breth*₂ folje; *ka*₁ emër, *ka*₂ parafrjalë, (ai) *ka*₃; *ndaj*₁ parafrjalë, *ndaj*₂ folje, *ndaj*₃ lidhëz etj. Mund të ndërthuren edhe me homonimet leksikore dhe krijohen grupe të gjatë: *re*₁ emër i avujve në qiell, *re*₂ notë muzikore, *re*₃ nuse e re, (ai ve) *re*₄, (ti) *re*₅, *re*₆ si shkurtim i *ore*. Si homonime të tilla dalin gjithnjë emrat abstraktë nga pjesorja dhe mbiemri në shumës të shquar po nga ajo pjesore, p.sh. të *bërët*₁ (bërja) dhe të *bërët*₂ (ata të pjekurit). Këto homonime, si edhe të tjerat, shërbejnë në letërsi për lodra fjalësh, kalambure, për rima. Në gjuhësi paraqesin interes, kur janë shkak i dëbimit të njera tjetrës dhe për mënyrën e paraqitjes së tyre në fjalorë.

Çështje të veçanta ngrenë këtu pjesët e pandryshueshme të ligjeratës, lidhëzat, parafrjalët, pjesëzat. Dallimi i tyre nuk ka qenë gjithnjë i lehtë, nga një fjalor i shqipes në tjetrin ndeshemi me paraqitje e trajtim të ndryshëm. Mjafton të shënojmë se në Fjalorin e gjuhës shqipe, megjithë hapin e madh në krahasim me fjalorët e tjerë, jo quhet ndajfolje mohimi, ndërsa *po* pjesëz (me sa duket, për ta dalluar nga homonimi *po* ndajfolje), ndonëse janë antonime të plota e nuk mund t'u përkasin pjesëve të ndryshme të ligjeratës. Del i nevojshëm një studim i kujdesëshëm i pjesëzave dhe pjesëve të tjera të ligjeratës të pandryshueshme që dalin homonime, për të arritur në fjalorë një paraqitje të saktë, të drejtë nga ana shkencore dhe të

29) Shih E. Cabej, *Studime rreth etimologjisë së gjuhës shqipe, I*, "Bul. U'n. Sht. të Tiranës", S. Shk. Shoq. 1960, N. 4, f. 47-48.

lehtë për t'u kapur, në mënyrë që p.sh. *pra* lidhëz dhe *pra* ndajfolje të mos gjenden në një vend, ndërsa për *sa* të mos jenë bashkë edhe kuptimet, edhe homonimet.

Për shkak të homonimisë së mbaresave homonimet leksiko-gramatikore mund të dalin si të tilla në disa forma, pra *vesh*₁ emër dhe *vesh*₂ folje janë homonime dhe më tej: *veshi*₁-*veshi*₂, *veshin*₁-*veshin*₂, *veshët*₁-*veshët*₂ etj. Klasifikimi i mëtejshëm i homonimeve leksiko-gramatikore nuk paraqet interes. Mund të shënohet vetëm që ato ndeshen kryesisht ndërmjet emrave me foljet.

Nëndarjen e tretë të madhe të homonimeve në gjuhën shqipe e përfaqësojnë *homonimet e pjesëve të ligjeratës*. Këto janë fjalë që tingëllojnë njësoj, kanë kuptim leksikor të afërt, por kuptimin themelor gramatikor të ndryshëm, u përkasin pjesëve të ndryshme të ligjeratës. Folja *ndryshk* dhe emri *ndryshk* do të ishin variante leksiko-semantike të një fjale, nëqoftëse nuk do të ishin pjesë të ndryshme të ligjeratës.

Nga fjalët që dalin si homonime të tilla në formën e marrë si përfaqësuese për t'u paraqitur në fjalorë, po përmendim foljet: *plak*, *përshesh*, *ngut*, *ngel*, *kthis*, *kep*, *kyç*, *hov*, *hap*, *grep*, *qelb*, *guk*, *shtyp*, *shuk*, *tjerr*, *thuk*, *zdap*, *zdrug*, *dhen*, *eh*, *kuvend*, *nder*, *çap*, *lind*, *harr*, *gardh*, *zgardh*, *ngul*, etj. (për kuptimet shih Fjalorin e gjuhës shqipe, 1954), që dalin njësoj në tingëllim me emrat përkatës: *plak*, *përshesh*, *ngut*, *ngel*, *kthis*, *kep* etj. Po kështu foljet: *ngul*, *përkrrah*, *përmbys*, *qull*, *truc*, *mbrodh*, *ndesh*, *ndoht* dalin njësoj në tingëllim me ndajfoljet e afërta në kuptim me to: *ngul*, *përkrrah*, *përmbys*, *qull*, *truc*, *mbrodh*, *ndesh*, *ndoht*. Emrat: *tatëpjetë*, *vërdallë*, *zvarë*, *çift*, dalin njësoj në tingëllim me ndajfoljet: *tatëpjetë*, *vërdallë*, *zvarë*, *çift*. Emrat: *faqekuq*, *terak*, *shurdhac*, *murrak*, *qukapik*, *kambëzezë*, *lakuriq* etj. dalin homonime me mbiemrat: *faqekuq*, *terak*, *shurdhac*, etj. Nga shqyrtimi i këtyre homonimeve del, se çiftet *folje* — *emër* dhe *folje* — *ndajfolje* në pjesën më të madhe kanë lindur prej kohësh, ndërsa vazhdon edhe sot krijimi i çifteve *emër-ndajfolje* dhe *mbiemër-emër*.³⁰⁾ Në gramatikën e gjuhës së sotme shqipe në këto dy rastet e fundit flitet për kalimin e fjalëve nga një pjesë e ligjeratës në një tjetër, ndërsa në fushën e fjalëformimit del kështu nevoja për studimin e konversionit në gjuhën shqipe. Për leksikologjinë, e në veçanti për homoniminë, këtu ka rëndësi të përcaktohet nëse kemi të bëjmë tashmë me dy fjalë të veçanta, me dy njësi leksikore, apo vetëm me një. Në shembujt që u sollën sipër, na duket se kemi tashmë dy fjalë të veçanta: nga njera anë një emër, nga ana tjetër një mbiemër ose një ndajfolje. Por me që procesi është i gjallë në gjuhë, shumë raste të tjerë diskutohen. Mbiemri i *sëmurë*, përshembëll, përdoret edhe i substantivuar *i sëmurë-i*; emri *grumbull* përdoret edhe si ndajfolje. Kemi dy fjalë këtu, apo vetëm një? Studimi i hollësishtëm i pjesëve të ligjeratës edhe në planin leksiko-semantikor do ta lehtësonte zgjidhjen e kësaj çështje. Si kriter leksikor mund të shtrohej ky: a ka nevojë gjuha për një fjalë të re, që të shënojë një nocion të ri (e në këtë rast përdor materialin e gatshëm që ka), apo kemi vetëm një zhvillim të mëtejshëm të nocionit të mëparshëm, zhvillim që sjell në një përdorim më tepër sintaksor të fjalës. Mbiemri *tradhëtar* shënon edhe cilësinë e njeriut, edhe vetë njeriun tradhëtar, pa krijuar një nocion të ri. Ndërsa mbiemri *i drejtë* vetëm në gjininë femërore *e drejtë-a* (si gjini e pjesës më të madhe të përgjithësimeve abstrakte në shqipen) shënon një nocion të ri në drejtësi, nuk ka mbetur një përdorim i mbi-

30) Përsa i përket adjektivizimit të emrave, p.sh. *kyç* dhe *problemi kyç*, mendojmë se në përgjithësi nuk shpie në një mbiemër të vërtetë, ndoshta me ndonjë përjashtim të rrallë ose tek ndonjë kompozitë emër+emër në rol mbiemëror.

emrit, siç është p.sh. mbicmri i substantivuar i drejti. Emri *grumbull* përdoret si ndajfolje po me atë kuptim, ndërsa ndajfolja *rreth* (dhe parafjala) nuk janë thjesht përdorim i emrit *rreth*, por mbi bazën e kuptimit të tij si pikënisje, shënojnë tashmë një nocion të ri, për të cilin kishte nevojë gjuha. Lindja e një fjale të re, si pjesë e ndryshme e ligjeratës nga fjala bazë, pra lindja e homonimeve të pjesëve të ligjeratës, duhet medocmos të shoqërohet me ndryshime të brendshme të fjalës, si nga ana semantike, ashtu dhe gramatikore; p.sh. mbicmëri *punëtor* përdoret si mbicmër i substantivuar (dembeli nuk ja kalon dot *punëtorit*), por nga ana tjetër kemi një emër më vete *punëtor-i*, i cili shënon një nocion të ri, që ka pësuar ndryshime semantike, kaq sa mund të themi *punëtor dembel*, gjë që nuk do ta lejte ruajtja e kuptimit themelor të mbicmrit, hyn në një fushë tjetër semantike (*punëtor*, fshatar, intelektual, kapitalist etj.) nga ajo e mbicmrit (*punëtor*, i zellshëm, dembel, përtaq etj.), nga ky emër mund të formohen fjale të reja si *punëtori*, *lashkëpunëtor*, ndërsa nga ana gramatikore ai ka të gjithë paradigmen e emrit, ka humbur përfundimisht mundësinë e formimit të shkallëve të krahasimit, gëzon të gjitha lidhjet sintaksore të një emri.

Kur kuptimi leksikor është larguar krejt dhe nuk ndjehet më ndonjë lidhje ndërmjet tyre, atëhere kemi homonim, leksiko-gramatikore si u pa më lart me disa pjesëza e parafjalës, ose p.sh. në *curr₁* shkëmb dhe *curr₂* për curroj; kështu që homonimia e pjesëve të ligjeratës është etapa e parë në zhërrimin e polisemisë, që jep homonimi leksiko-gramatikore.

Në homonimet e pjesëve të ligjeratës mund të përmenden edhe ato, që lindin në forma të veçanta të fjalëve, për shkak të homonimisë së mbare-save ose prapshitesave. P.sh. *gjethet* është edhe shumësi i emrit *gjehe* edhe veta e tretë e foljes për gjetchet, gjethtëson; *mbartje* është edhe emri foljor, edhe një formë e foljes *ti mbartje*; shembuj të tillë si përputhje të rastit mund të ndeshen mjaft, sidomos midis mbicmrave dhe emrave në të njëjtën rrënjë (zakonisht me prejardhje të huaj) — kështu *kritike* është edhe gjinia femërore e mbicmrit, edhe një rasë e pashquar e emrit. Huazimet këtu mund të dalin edhe thjesht si homonime leksiko-gramatikore: *masiv* emër dhe *masiv* mbicmër, *objektiv* emër dhe *objektiv* mbicmër etj.

Deri këtu është patur parasysh vetëm ana tingëllore e fjalëve. Mirëpo shkrimi sot ka marrë një rëndësi kaq të madhe, sa që nuk mund të lihet mënjandë. Për shkak të ortografisë kryesisht fonetike, në gjuhën shqipe homonimet edhe shkruhen njësoj. Rastet, kur homonimet vetëm tingëllojnë njësoj, por shkruhen ndryshe, janë fare të rrallë në shqipen: *dhëmbëz* dhe *dhimbës*, *lag* dhe *lak*, *hidhka* dhe (ai) *hidhka*, *gishhtëz* dhe *gishhtës* etj. Zakonisht këto quhen homofone. E kundërta e tyre janë homografet: fjale të ndryshme, që vetëm shkruhen njësoj, por shqiptohen ndryshe, meqë kanë theksa të ndryshëm, p.sh. *ari-ari*, *bari-bari*, *xhami-xhami*, *para-pará* etj. Në shqip kemi një tip të homografëve, që është i përherëshëm: emri i përgjithshëm i gjinisë femërore në të pashquar (që tregon një shkencë apo degë) është homograf me emrin e gjinisë mashkullore të shquar njëjës (që tregon, njeriun e lidhur me atë degë, apo shkencë), p.sh. *bletari-bletari*, *argjendari-argjendari*, *agronomi-agronomi*; ose: *atdhetari-atdhetari*, *drejtori-drejtori*, *breshëri-breshëri* etj. Një homografi e tillë lind nga që rrënja e fjalëve është po ajo.

Ndryshimi ndërmjet shkrimit dhe shqiptimit lind vështirësi të ndryshme, kur shqyrtohen fjalorët e botuar në kohë të ndryshme. Për shkak të ortografive të ndryshme, në ta mund të dalin si homonime fjale që nuk janë të tilla dhe e kundërta, nuk dalin si homonime ato që janë.

4

Përfundimet që mund të nxirren për praktikën leksikografike nga vëzhgimet mbi homonimet në gjuhën shqipe, nuk do të ishin të plota, pa shqyrtuar njëkohësisht edhe paraqitjen e homonimeve në fjalorët e derisotëm. Megjithatë një shqyrtim i tillë ndesh në dy vështirësi kryesore. Së pari, problemi i formës themelore, i formës përfaqësuese të fjalës në fjalor, ka gjetur zgjidhje të ndryshme sipas autorëve, veçanërisht për foljet, gjë që sjell luhatje të mëdha në numurin e homonimeve. Kështu, ndërsa në Fjalorin e shkurtër shqip-rusisht (1951) kemi dy homonime *kushtoj₁-kushtoj₂*, tek Fjalori i gjuhës shqipe (1954) kemi tjetër formë përfaqësuese: *kushtoj-kushton* dhe homonimia fshihet, tek Fjaluer i Rii i Shcypes, Shkodër, 1908, merret si formë përfaqësuese veta e III e aoristit, prandaj nuk dalin homonime p.sh. *shkrep* emër dhe *shkrep* folje; nuk dalin homonime *pres₁-pres₂* në Fjaluer i voghel scyp e ltinisht, Shkodër 1895, nga J. Junku, sepse atje merret infinitivi *me pree-me prit*, e po ashtu në fjalorin e F. Cordignano-s nuk dalin *bie₁-bie₂*. Vështirësia më e madhe del në sistemin e dhënies së homonimeve, në mënyrën grafike të dallimit të homonimeve nga kuptimet e një fjale të vetme. Çështja është se brenda po atij fjalori nuk ruhet i njejtë parim. Në fjalorin e S. Mann (An historical albanian-english dictionary, 1948) nuk kemi shenja të veçanta për homonimet, por janë ndarë në vende të veçanta *bie₁-bie₂*, ndonëse *diktoj₁-diktoj₂* jepen bashkë, të ndara me shifra arabe, si kuptime të një fjale; jepen si homonime veçan *çaj₁-çaj₂*, por jepen bashkë *dhe₁*, lidhëz, *dhe₂*, nga folja *jap*, kurse *dhe₃* për *tokë* jepet veçan si homonime; bashkë janë dhënë *gaz₁-gaz₂*, *gram₁-gram₂*, *gjatoj₁-gjatoj₂*, *do₁-do₂* etj. Tek fjalori i A. Leotti-t (Dizionario albanese-italiano, Roma, 1937) në fillim homonimet jepen në një vend, të ndara aty-këtu me shifra, kështu tek *a* është futur madje dhe trajta e shkurtër e parashitesa, që nuk ndeshen veçan, ndërsa tek *po* jepen 6 homonime të veçanta, tek *që* 7 etj. Në fjalorin e G. Weigand (Albanesisch — deutsches und deutsches-albanesisches Wörterbuch, Leipzig, (1914) homonimet janë ndarë edhe në glosa të veçanta, edhe me shifra romake, por kjo nuk ruhet deri në fund, homonimet tek *jo* jepen si kuptime, po ashtu *na* përemër dhe *na* për *merre*. Në fjalorin shqip-greqisht të K. Kristoforidhit (1961) homonimet tek *po* jepen në një vend, të ndara me shifra arabe, kurse *na* jepen 4 homonime si fjalë të veçanta, janë ndarë dy homonime *që*, kurse *po* pjesëz dhe *po* lidhës kundërshtore jepen bashkë etj. Fjalori i gjuhës shqipe i vitit 1954 i është përmbytur deri në fund një parimi të vetëm, po ashtu si Fjalori i shkurtër shqip-rusisht, gjë që e lehtëson shumë edhe përcaktimin e qëndrimit të tyre ndaj homonimeve. Megjithatë, mungesa e shenjave dalluese për homonimet në fjalorin e parë, mund të sjellë ngatërresa praktike, p.sh. kemi tre homonime *koll*, fjala e tretë referohet tek *kollë*, kurse tek kjo *kollë* kemi po ashtu dy homonime. Që këtej del një një kërkesë për çdo fjalor të ardhshëm: homonimet të pasqyrohen sipas një parimi të vetëm, të eaktuar që më parë dhe të dallohen nga ana grafike në mënyrë të njejtë. Vendin e parë nga renditja është e mira ta zërë gjithnjë fjala homonime, që është më e përdorur, më e përhapur.

Kërkesa themelore, që shtrohet përpara çdo fjalori, është që të arrihet një paraqitje sa të jetë e mundur më e drejtë dhe sa më e përpiktë nga ana shkencore e sistemit leksikor të gjuhës shqipe, për periudhën, të cilës i përket fjalori qoftë kjo edhe në dritën e një çështje të ngushtë, siç është homonimia. Në fjalorët e parë, për shkak të sasisë së kufizuar të materialit

leksikor, çështja e homonimeve nuk ka dalë (p.sh. në pjesën shqip-gjermanisht të fjalorit tek I. R. von Xylander, Die sprache der Albanesen oder Schkipetaren, Frankfurt am Main, 1835). Me shtimin e fjalëve nga një fjalor në tjetrin, është rritur numuri i homonimeve, por janë veçuar kryesisht ato, që ndryshojnë mjaft, pra homonimet leksiko-gramatikore (çaj₁ emër -çaj₂ folje, dhëmb₁ - emër -dhëmb₂ folje, zë₁ emër -zë₂ folje etj.) dhe homonimet e pjesëshme. Me thellimin e studimeve etimologjike, edhe në fjalorë hyri parimi etimologjik i dallimit të tyre, gjë që del qartë në fjalorin etimologjik të G. Meyerit (Etymologisches Wörterbuch der Albanesischen Sprache, Strassburg, 1891) dhe në fjalorin e G. Weigandit. Fakti që në disa fjalorë edhe të mëvonshëm gjejmë në një vend homonimet etimologjike (p.sh. *brimë*₁ për *brimë*, *brimë*₂ për vrimë dhe *brimë*₃ për *brymë* nuk dallohen në fjalorët e S. Mann, F. Cordignano dhe tek L. Lukaj, Fjaluer shqyp-srbohrvatisht, Beograd, 1935) shtron nevojën e një studimi të mëtejshëm të historisë së fjalës, si punë paraprake edhe për hartimin e fjalorëve. Numuri i homonimeve me burim të ndryshëm është rritur dhe vazhdon me gjallëri edhe sot të rritet sidomos me hyrjen e fjalëve të ndryshme nga dialektet në gjuhën e përbashkët. Veç arsyeve të tjera, edhe për shkak se mund të dalë një mori e madhe homonimesh, është e mira që në fjalorët të jepen me kujdes trajtat dialektore të fjalëve: ato që do të jepen, të dallohen mirë, kur janë homonime. Për fjalorët nuk ka qenë gjithnjë e lehtë të bëhet dallimi i këtyre homonimeve. Në fjalorin e L. Lukaj dhe S. Mann gjejmë në një folë *çingare*₁ për cigare dhe *çingare*₂ për zile bagëtish; tek J. Junku janë ngatërruar *fuçi* dhe *fuqi* për shkak të shqiptimit dialektor të afërt (*fucii*, a potere, foza, botte); *gocë*₁-*gocë*₂ jepen si një fjalë tek A. Leotti, F. Cordignano, K. Kristoforidhi; tek S. Mann jepen në një vend *brom*₁-*brom*₂ dhe po atje shtohet *bromp*, ndërsa tek *bacë* futet edhe kuptimi shishe (bottle) për Pëzën, *çikëz*₁-*çikëz*₂ jepen në një folë etj. Fjalori i gjuhës shqipe, për shkak të materialit të gjërë, ka mjaft homonime dialektore, nga të cilat, për mendimin tonë, një pjesë mund të ishin shmangur, ti p.sh. në fjalët *çë*₁-*çë*₂, *boj*₁-*boj*₂, *kumë*₁-*kumë*₂, *dreq* për drejt, *merë* për tmerr etj. Punimet dialektologjike, studimi i gjeografisë së fjalës, do të zgjidhin jo vetëm çështjen e fatit të fjalëve dialektore për gjuhën e përbashkët, por do të ndihmojnë edhe për sqarimin e ndikimit të homonimisë në gjuhë.

Marrëdhëniet e shqipes me gjuhët e tjera vazhdojnë edhe sot e kësaj dite, sidomos në fushat e kulturës, politikës, në degët e veçanta të shkencës e teknikës. Prandaj mbetet ende mundësia e lindjes së homonimeve nga huazimet. Rrugët e hyrjes së fjalëve të huaja janë nganjëherë të ndërlikuara; si duket, kjo ka qenë arsyeja e paraqitjeve jo të përpikta në fjalorët e mëparëshëm. Kështu p.sh. janë konsideruar si një fjalë *bel*₁-*bel*₂ në fjalorët e L. Lukaj, S. Mann dhe në Fjalorin e shkurtër shqip-rusisht; *gradë*₁-*gradë*₂ në Fjalorin e F. Cordignanos-s dhe tek Fjaluer i Rii i Sheypës, Shkodër, 1908 *ashik*₁-*ashik*₂ tek A. Leotti, L. Lukaj dhe Fjalori i shkurtër shqip-rusisht etj. Në Fjalorin e gjuhës shqipe, në disa raste vihet re një përpjekje për ta shmangur homoniminë, atje ku ajo del në të vërtetë: *kros*-*kross*, *boj*-*bojë*, *odë*-*ode*, *kafas*-*kafaz* etj.

Kërkesa të reja lindi nevoja e shkoqitjes së strukturës semantike të fjalës. Përpjekjen e parë më serioze për këtë e kemi tek fjalori i K. Kristoforidhit. Zgjidhjet e drejta në këtë fjalor, po të krahasohen edhe me fjalorë të mëvonshëm të autorëve të huaj, tregojnë se tek hartuesit shqiptarë të fjalorëve kemi patur gjithnjë një kuptim më të drejtë të strukturës semantike të fjalës shqipe, e si rrjedhim, edhe një paraqitje të drejtë të homoni-

meve. Megjithatë, mungesa e përpunimit teorik të anëve të polisemisë dhe të homonimisë ka sjellë në lëkundje të dyanëshme: ose homonimet janë quajtur si polisemi, ose polisemia është paraqitur si homonimi. Kështu tek K. Kristoforidhi janë dhënë si fjalë të veçanta *pikë* dhe *pikë* për apopleksi; *çel* dhe *çel* për ndez zjarrin. Një coptim të madh të fjalëve gjejmë tek A. Leotti; në një faqe të vetme janë ndarë si homonime *cek₁* për prek dhe *cek₂* për dëmtoj pak, *i cekët* për jo i thellë dhe *i cekët* për artificial, *cen₁* e metë dhe *cen₂* zakon, ves. Veçimi i kuptimeve të fjalëve të ndryshme tek ky fjalor i fundit nuk na bën të mendojmë, se ishte shtruar tashmë problemi i zbërthimit të polisemisë në homonimi, problem ky që me sa duket, del për herë të parë në Fjalorin e shkurtër shqip-rusisht, meritë e të cilit është dhe përpjekja për një shtresëzim stilistik të leksikut të shqipes. Megjithatë autorët, si duket, i janë përbajtur mendimit mbi mundësinë e zbërthimit të lehtë të polisemisë në homonime, gjë që duket nga shembujt e dhënë si homonime: *bashkim₁-bashkim₂*, *pajtoj₁-pajtoj₂* (me gjithë fjalët e prejardhura), *plot₁-plot₂*, *ngjit₁-ngjit₂*, *pjesë₁-pjesë₂*, *përpiqem₁-përpiqem₂* (ndonëse kjo nuk zbatohet për emrin *përpjekje*) etj. Rezultatet më të mira të leksikografisë shqiptare dhe në lëmin e homonimeve janë pasqyruar në Fjalorin e gjuhës shqipe të vitit 1954. Veç shembujve, që u analizuan më sipër, mbeten edhe pak të tjerë, që kanë nevojë aty për një saktësim të mëtejshëm. Janë dhënë si dy fjalë të veçanta *balenë₁* për një sisor detar dhe *balenë₂* për bririn që nxirret nga dhëmbi i balenës, ndërsa tek *kastor*, mbasi tregohet për këtë brejtës, po aty shtohet se gëzofi i tij quhet edhe kastor, pa u nxjerrë kjo me shifër si kuptim i veçantë; janë ndarë si homonime *post₁* 1. ofiq i lartë; 2. postiqe dhe *post₂* njësit policie, ndonëse homonimi e vërtetë këtu është trajta dialektore e fjalës *postiqe*, *postë* me fjalën *post*; janë si homonime *lavire₁* vend thikë dhe *lavire₂* grua e ligë, por tek *lavirë* të dyja homonimet jepen si kupti me të një fjale, etj.

Homonimet e pjesëve të ligjeratës, ndonëse nuk janë trajtuar si të tilla, ka qenë e lehtë për t'u dalluar në fjalorë, kurse homonimet e lindura gjatë fjalëformimit (me gjithë zgjidhjet e drejta që gjenden në fjalorë) janë një çështje që ngrihet tashti vonë, me studimin e thelluar të fjalëformimit në gjuhën shqipe, e prandaj lëkundjet në paraqitjen e tyre mund të ndeshen në fjalorët. Tek J. Junku, homonimet *pjek₁-pjek₂* ngatërrohen tek *m'u pjek* dhe *t'piekun*, gjë që ndeshet edhe tek F. Cordignano dhe Fjaluer i Ri i Shecpës, Shkodër, 1908. Tek A. Leotti janë dhënë si një fjalë homonimiet e prejardhura *i paditur₁-i paditur₂*, *pasanik₁-pasanik₂*; janë ndarë foljet *vloj₁-vloj₂* por tek *vloj* jepet edhe u *vlua* për u fejuar etj. Tek S. Mann gjejmë si një fjalë *dorak₁-dorak₂*, tek L. Lukaj *gjatoj₁-gjatoj₂*; tek K. Kristoforidhi *gjëmoj₁-gjëmoj₂* etj. Në Fjalorin e gjuhës shqipe fjalët *maskullore*, *ditar*, *ditor*, *endëz*, *lakore*, *doçe*, *faqore* etj. janë në të vërtetë dy homonime të prejardhura të marra si kuptimet e një fjale të vetme. Homonimet gjatë fjalëformimit mund të lindin edhe paskëta, veçanërisht në krijimin e termave të rinj për terminologjinë e shkencave e degëve të ndryshme, ku njohja e shkaqeve të homonimisë dhe shmangia e saj janë kusht i rëndësishëm për arritjen e qartësisë dhe njëkuptimisë së termit; aq më tepër kërkohet këtu shmangia e formimeve të reja që mund të ngjallin asociacione jo të pëlqyeshme ose për të qeshur, për shkak të homonimisë. Problemet e kontaminimit homonimik dhe të përjashtimit të fjalëve për shkak të homonimisë në gjuhën shqipe janë cekur tashmë në punimet e prof. E Çabej rreth etimologjisë, ku janë sqaruar edhe mjaft raste të etimologjive jo të drejta për shkak të homonimisë së thjeshtë të etimoneve. Mbeten për t'u

parë më hollësisht çfaqjet e ndryshme të ndikimit të homonimeve në gjuhën shqipe dhe reagimi i saj ndaj tyre, e gjithashtu çështjet e ndryshme të homonimisë jo leksikore.

Në vija të përgjithëshme, kjo është edhe rruga e zhvillimit e plotësimit të nocionit mbi homoniminë në gjuhën shqipe.

Meqë lindja e homonimeve mbetet edhe sot një proces i gjallë, mbeten edhe raste të diskutueshme, si për çdo proces tjetër të papërfunduar, e kryesisht ndërmjet homonimeve të lindura nga polisemia dhe gjatë fjalëformimit nga po e njeja rrënjë, po ashtu për fjalët e ardhura nga dialektet e ndryshme dhe ato me etimologji të paqartë. Të paktën brenda të njejtit fjalor, këto raste do të jetë e mira të paraqiten njësoj, sipas kriterëve të caktuara që më parë për rastet e ngjashëm. Zgjidhja më e plotë e problemit mund të arrihej me hartimin e një fjalori special të homonimeve në gjuhën shqipe, fjalor që do të pasqyronte rezultatet e studimeve të të gjitha fushave të tjera të gjuhës shqipe, shkëputur nga të cilat nuk mund të sqarohet homonimia, fjalor kështu i diskutuar dhe i pranuar përgjithësisht, që do të shërbente si mbështetje për punimet e ardhëshme leksikografike.

Me ndryshimin e tipit të fjalorit, ka mundësi të ndryshojë paraqitja e homonimeve, pa e cënuar pasqyrimin e drejtë shkencor. Kështu në fjalorët etimologjikë dhe historikë homonimet e lindura nga polisemia do të gjenden në një vend, ndërsa rastet e kontaminimit do të zbërthehen; në fjalorët dialektorë do të kemi një pasqyrë tjetër, nga ajo e gjuhës së përbashkët etj. Ndërmjet fjalorëve shpjegues dhe atyre shqip-gjuhë e huaj nuk ka zëpse të ketë ndryshim tjetër, veç mënyrës së shpjegimit të tyre, në rastin e parë, dhe përkthimit, në rastin e dytë. Në fjalorët gjuhë e huaj-shqip gjatë përkthimit, fjalët shqipe që kanë një homonim tjetër, mund të pajisen me shënimin përkatës, për të mos lënë shteg për dyshime.

R é s u m é

OBSERVATIONS SUR LES HOMONYMES DE L'ALBANAÏS

En dehors de quelque simple mention des homonymes qu'on trouve dans les études d'avant la libération sur le lexique de l'albanais, on n'a pas un traitement vrai et propre des questions de l'homonymie de l'albanais.

Après la libération du pays, les premières définitions des homonymes se trouvent dans les préfaces des dictionnaires. D'autres aspects de l'homonymie ont attiré également l'attention dans des travaux particuliers et l'intérêt sur les manifestations de l'homonymie dans les différents domaines de l'albanais est venu croissant. Cependant, on doit encore admettre qu'on manque d'études généralisantes qui traitent théoriquement des questions de l'homonymie de la langue albanaise.

L'homonymie, dans la large acception du mot, comprend tous les genres de sons identiques, mais l'auteur ne traite que l'homonymie qui a affaire aux mots, aux unités lexicales (c'est-à-dire les homogrammes, dans l'acception de Marouzeau).

L'homonymie est la concordance sonantique d'unités lexicales différentes, de sorte que les homonymes sont des mots différents, mais de prononciation identique. Pour avoir des homonymes on doit avoir deux ou trois mots ou davantage, mais qu'ils aient une prononciation identique; on doit avoir présent aussi leur aspect grammatical, étant donné que les mots appartiennent tou-

jours également à une partie du discours, et cette dernière est une catégorie lexico-grammaticale.

La place principale va aux homonymes vrais et propres, c'est-à-dire aux homonymes lexicaux, qui représentent des mots de sens lexical tout à fait différent, ont le même son et appartiennent à la même partie du discours. Ces homonymes se retrouvent en albanais notamment chez les noms, un peu plus rarement chez les verbes, les pronoms, les parties invariables du discours.

La question principale chez les homonymes est la voie de leur naissance. Les homonymes lexicaux peuvent se faire jour au cours de l'altération, de l'évolution phonétique des mots naguère tout à fait lointains, ainsi p. ex. les couples d'homonymes suivants: verë₁-verë₂ ("été-vin"), urë₁-urë₂ ("pont-torche"), pjek₁-pjek₂ ("cuire-rencontrer"), pres₁-pres₂ ("couper-attendre"), etc. Ces homonymes peuvent être appelés aussi étymologiques. Ainsi, dans la distinction des homonymes peut intervenir aussi le principe étymologique.

La raison fondamentale de la naissance des homonymes est que la longue change, se développe. La mobilité et les changements dans la langue sont ressentis notamment dans les dialectes et le langage courant. Ainsi, l'autre voie de la naissance des homonymes est l'introduction des mots dialectaux et de ceux du langage courant. C'est à travers cette voie que sont pénétrés des homonymes comme korë₁ "croûte", korë₂ "icone" et korë₃ "délai, laps de temps, génération" et plusieurs autres groupes d'homonymes. Une partie de ces homonymes ne peuvent être que fictifs, des homonymes de dictionnaire, n'étant pas employés dans le même contexte ou sujet de langage.

L'autre voie est celle des emprunts. Les mots empruntés peuvent résulter des homonymes avec ceux de l'albanais: bar₁ "plante verte, herbe" et bar₂ "bar, buffet", emër₁ "nom" et emër₂ "ordre" (un emprunt du turc), etc.; les mots empruntés peuvent résulter des homonymes aussi entre eux: diktoj₁ "découvrir, dénicher" et diktoj₂ "dicter", ashik₁ "rotule du genou" et ashik₂ "amant", et plusieurs autres. La langue concorde avec ces homonymes du fait de l'emprunt, bien qu'il s'agisse d'une raison extérieure, considérant le fait que l'homonymie se fait jour notamment sur la base intérieure.

Les homonymes peut se faire jour au cours de la formation des mots, donc il s'agit de dérivés: pjek₁-pjek₂ qui donnent lieu aux substantifs verbaux pjekje₁-pjekje₂ ("cuisson-rencontre"). D'autres tirent leur origine de racines complètement différentes: rendoj₁ "ranger" et rendoj₂ "râper", pasanik₁ "riche" et pasanik₂ "artisan, adepte, qui suit". A cette deuxième catégorie d'homonymes appartient presque tous les adjectifs dérivés: i paditur₁ de padis "accuser" et i paditur₂ "ignorant, qui ne sait pas" de me dijte "savoir".

Les exemples de l'albanais montrent que l'homonymie peut tirer son origine aussi de la même racine, alors que les dérivés, sont formés par des affixes homonymiques: arrëz₁ "noyeraie, noiseraie" et arrëz₂ "vertèbre cervicale". Tantôt, la construction intérieure, la forme intérieure des mots est entièrement différente; enfin, le mot peut donner le jour à des parties différentes du discours: fillorë₁ "école primaire" et fillorë₂ "nappe velue", fushorë₁ "petite plaine" et fushorë₂ "de campagne (considéré comme adjectif)". La distinction de ces homonymes présuppose une analyse morphologique exacte et juste des mots au point de vue du système actuel de la langue albanaise.

Certains verbes donnent lieu à des homonymes dans leur forme passive: fshij (balayer) et fsheh (cacher) donnent fshihem₁-fshihem₂, ngre (soulever, élever) et ngrij (avoir froid, s'engourdir) donnent ngrihem₁-ngrihem₂.

La dernière voie est celle de la polysémie. C'est une question assez discutée. A ce sujet, l'auteur donne tout d'abord une définition du sens lexical,

des variantes lexico-sémantiques et de la polysémie, cela dans l'intention de la distinguer de l'homonymie. L'homonymie appartient foncièrement à la synchronie de la langue, de là aussi le principe étymologique ne peut être évoqué dans ce cas comme l'unique et le définitif. Comme principe fondamental permettant de discerner l'homonymie de la polysémie il considère: la détermination du lieu du mot dans le système actuel de l'albanais. Ce lieu est déterminé non seulement par des liens étymologiques, mais également par les liens actuels avec les choses et les notions, des liens dans les séries de la formation des mots, des liens lexicaux (de l'ordre des antonymes, des synonymes, du domaine de la sémantique, de la phraséologie), des sphères et des souches stylistiques d'usage, des liens morphologiques et syntaxiques. C'est à la lumière de ce principe, ou plutôt de ce procédé, que l'auteur analyse quelques exemples tirés du Dictionnaire de l'albanais 1954, où sont donnés comme polysémie des cas d'homonymie.

L'auteur exprime l'avis qu'il y a des cas en albanais ou de la polysémie se sont faits jour les homonymes: shalë₁ "cuisse", shalë₂ "selle de cheval, de vélo"; kallëzoj₁ "montrer, narrer, conter" et kallëzoj₂ "l'action de former l'épi par le plant".

La raison pourquoi l'une des variantes lexico-sémantiques du mot est scindée comme un mot en soi, peuvent relever: de la chute du chaînon intermédiaire (gjellë₁ "mets" et gjellë₂ "vie, existence", kafshë₁ "bête, animal" et kafshë₂ "chose, objet" — des homonymes historiques ceux-ci); elle peut donner lieu à des développements divers dans les dialectes: çikë₁ "miette" et çikë₂ "fille"; le mot peut être employé comme un terme dans un domaine particulier: thekës₁ "accent" et thekës₂ "un outil à faire rôtir, à faire griller (le pain)", ou bien, en dernier lieu, y peuvent intervenir aussi des influences extérieures.

Ainsi, les homonymes lexicaux peuvent être ramenés à trois grands groupes, avec leurs sous-divisions ultérieures: homonymes étymologiques, homonymes dérivés (de la formation des mots), homonymes sémantiques (de la polysémie). L'action concordante de tous ces facteurs a porté en albanais un nombre non petit de couples et même de groupes d'homonymes.

La seconde grande division des homonymes est constituée par les homonymes lexico-grammaticaux, qui sont deux ou plusieurs mots qui sonnent similairement, ont des sens lexicaux différents et qui appartiennent aux différentes parties du discours: kisha₁ "j'avais" et kisha₂ "église", dhe₁ "terre, sol, terroir" et dhe₂ "et (conjonction copulative)", (ti) dhe₃ "(tu) as donné", çaj₁ "thé" et çaj₂ "fendre, fendiller, couper". Les voies de leurs attaches sont les mêmes.

La troisième grande division est formée par les homonymes des parties du discours, qui sont des mots qui sonnent identiques, ont des sens lexicaux approximatifs, mais appartiennent à différentes parties du discours: p. ex. les verbes ndryshk "rouiller", plak "vieillir", qelb "puer" et plusieurs autres sont homonymes des noms ndryshk "rouille", plak "vieux, vieillard, ancien", qelb "pus".

De tels homonymes sont représentés par quelques verbes avec des adverbes, quelques noms avec des adverbes et quelques adjectifs avec des noms. Chez ceux-ci continuent même de nos jours à prendre naissance des homonymes entre des noms et des adjectifs, d'autres part entre des noms et des adverbes. Une attention particulière mérite en cela le passage d'une partie du discours dans une autre, la conversion en albanais. En lexicographie il est important d'établir le principe de leur insertion dans les dictionnaires.

Quelques homonymes des parties du discours se font jour également dans des formes particulières des mots.

En albanais on a aussi des homographes, des mots qui s'écrivent de la même façon, mais qui se lisent différemment en raison de l'accent, et des homophones, des mots prononcés par le même son mais écrits différemment.

D'un examen de plusieurs dictionnaires fondamentaux de l'albanais, où il ressort parfaitement la voie du développement et d'achèvement de la notion de l'homonymie en albanais, l'auteur fait relever les écarts et les imprécisions de l'insertion des homonymes dans ces dictionnaires, exemples à l'appui. Il fait relever aussi les voies à travers lesquelles se font jour des homonymes albanais même dans la langue d'aujourd'hui.

En conclusion, l'auteur met l'accent sur le besoin de reproduire justement les homonymes dans les dictionnaires à paraître, de sorte qu'on puisse les représenter exactement au point de vue scientifique du système lexical de l'albanais pour la période à laquelle appartient le dictionnaire. Ce partant, il aborde des aspects particuliers de la pratique lexicographique et examine le besoin d'élaborer un dictionnaire des homonymes de l'albanais d'aujourd'hui.

Faint, illegible text, possibly bleed-through from the reverse side of the page. The text is arranged in several lines and appears to be a list or a series of entries, but the characters are too light to transcribe accurately.